


Kumbona e së Diellës



Përshumëvjet Krishtindjen dhe Vitin e Ri

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

Nr.11/12, Nëntor - Dhjetor 2017

ARDHJA - ADVENT

Ardhja – Advent (latinisht “adventus”), është periudha liturgjike kishtarë që ndërlidhet me përgatitje për festën e Kërshëndellave. Dhe të njëjtën kohë fillimi i vitit kishtar. Në Kishën katolike ardhja apo adventi fillon 4 javë para

Kërshëndellave, ashtu mund të fillojnë që nga 27 nëntori dhe më së vonit me 3 dhjetor, kurse përfundon me 24 dhjetor që është buzmi apo nata e Kërshëndellave. Në liturgjinë katolike përdoret ngjyra vjollce si edhe lexohen gjatë meshës leximet adekuatë.

Gjatë ardhjes sipas traditës punohen kurorat nga gjethi i selville ku vendosen katër qirinj që simbolizojnë 4 dielat e ardhjes. Kryesisht në këtë kohë mbretëron atmosfera e shpresës, vigjilencën dhe dëshirat e zjarra. Vigjilenca është hapja e zemrës, vetëdija e thellë si edhe përmbajta e brendshme e njeriut. Krishterët vigjilojnë dhe e njohin Zotin që po vejnë. Dhe të njëjtën kohë edhe gjyqin e fundit.

Ardhja apo Adventi filloi që nga shekulli i V, kur ipeshkvi i Toursit Perpetuo filloi për tu përgatitur për festën e Kërshëndellave duke filluar nga dita e Shën Martinit më 11 nëntor, dhe ishte kjo kohë e barabartë me kohën e kreshmëve 40 ditë dhe quhet 40 ditë e mënjillet e Shën Martinit.

Gjatë shekullit VI papa Gregori (Gega) i Madh e shkurton në katër javë që është edhe sot e kësaj ditët dhe lejohet të hanë mish dhe ushqime nga qumështi që nuk ishte e lejuar më përpara.

Koha e ardhjes lidhur me liturgjinë e Romës nuk ishte kohë pendese si ajo e kreshmëve por përgatitje për gëzimin e Kërshëndellave. Me kohë ardhja bëhet urë lidhëse në mes pendesës dhe kohës së pritjes. Dhe mbetet koha e ardhjes pa ndryshueshme deri në Koncilin e dytë të Vatikanit, cili shpjen disa ndryshime që dallon kohen e kreshmëve nga atë ardhjes (adventi).

Sipas besimit krishterë, historia e njerëzimit shkon në rrjedhat tragjike nga njerëzit e parë që marrin rrugën e keqes dhe tjetërsimin nga Krijuesi (Hyji) dhe nga njeriu. Për këtë Hyji intervenon për ta shpëtuar njeriun e tjetërsuar dhe i premtan shpëtimin dhe fitoren mbi të keqen. Ashtu besëlidhja e vjetër ishte koha e pritjes dhe e ardhjes. Po ashtu profet e besëlidhjes së vjetër e paralajmëron shpëtimtarin Jezu Krishtin dhe lindjen e tij siç është libri i dytë i Samuelit kapitulli 7 dhe rreshti 12. Po ashtu profeti Isaia 7,14, profeti Mikea që paralajmëron se shpëtimtari Jezusi do të linin në Betlehem (Mik 5,1)

Tradita e ardhjes apo adventit janë kurorat e ardhjes që nuk është asgjë tjetër përveç simboli nga antika i fitores. Ashtu ardhja është simbol i luftës kundra errësirë. Kjo luftë është me shumë shpresë që simbolizon fitoren e Jezu Krishtit: Kryqin e Jezusit dhe Ngjalljen e tij.

Idea e kurorës së ardhjes filloi nga vitit 1838 në një shtëpi e fëmijëve të varfër “Das Rauhe Haus” në Hamburg. Kurofe bëhet nga gjethet e selvisë që simbolizon pavdekshmërinë, kurse gjethi i lari simbolizon fitoren kundra mëkatit dhe vuajtjeve, cedri simbolizon fuqinë dhe shërimin nga sëmundjet. Fletët e gjethit të larit të egër përkujtojnë kurorën nga ferrat etj.

Rrethin apo kurore që gërshetohet nga gjethet e gjelbërta vendosen në të 4 qirinj që përkujtojnë historinë e njerëzimit: krijimin, mishërimin, shpëtimin dhe përfundimin. Në dielën e parë të ardhjes ndezët qiri i parë, kurse në dielën e dytë ndezët qiri i parë dhe i dyti, në dielën e tretë qiri i parë, i dyti dhe i treti kurse në dielën e katër qiri i parë, i dyti, i treti dhe i katërti. Ngjyra violet është simbol pendese dhe kthimit si dhe përgatitja për ardhjen e Krishtit. Sipas një tradite qiri i parë është qiri i profeti, qiri i dytë i Betlehemit, qiri i tretë i barinjve dhe qiri i katër i engjëjve.



Konferenca Ipeshkvnore MBRETËRIA E HYJIT	4
Dom Giovani Kokona BUKURIA E THIRRJES	6
Giovanni Cussi S.I. ÇIFTI DHE SFIDAT E KOHËS	8
Dom Lush Gjergji GIORGO LA PIRA	11
Pierluigji Battista PAPA FRANÇESKU	15
Dom Nosh Gjolaj PUSHIMI DHE UDHTIMI I PROGRAMUAR	16
Dom Ernesto Koci STUDIME ETNOLOGJIKE	19
Gjovalin Shkurtaj SHQYPTARIJA DHE NDRE MJEDA	23
Mirela Kumbaro MISSIONARË IDEALISTË, SHËRBESTARË TË DIJES DHE KULTURËS	25
KONGRESI I MANASTIRIT	26
VITRINA E LIBRIT	28

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXI, nr. 11/12 (501-502) Nëntor - Dhjetor 2017

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Dom Artur Jaku
Dom Gjovalin Simoni

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon NIKA
Fotografe: Luli Ndreu

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

MBRETËRIA E HYJIT ËSHTË MBRETËRI PAQE DHE DREJTËSIE

Mesazhi i ipeshkvijve katolikë për krishtlindje 2017



“Populli që ecte në errësirë pa një dritë të madhe” (Is 9,1)

Krishtlindja është festa e dritës. Për ne Krishti është drita që shkëlqen në errësirë (Gj 1,5), ai i cili vjen nga drita e Atit për të shndritur errësirën përreth nesh e brenda nesh. Kjo festë është solidariteti i Hyjit me njeriun. Në Krishtlindje Hyji merr mishin njerëzor, ashtu të plagosur e të vuajtur, dhe i jep një dinjitet njeriut, duke përtërirë marrëdhënien me të e duke shtruar kështu rrugën e vëllazërimit midis njerëzve. Natën e Krishtlindjes në të gjitha kishat tona do të jehojë fjala e Isaisë profet: *“Populli që ecte në errësirë pa një dritë të madhe, për banorët që jetonin në krahinën e hijes së vdekjes zbardhi për ta drita” (Is, 9,1).*

Po çfarë është errësira?

Konteksti në të cilin është thënë kjo shprehje na sjell ndërmend shpërnguljen e

popullit të Izraelit, skllavërinë e tij, largësinë e tij nga tempulli dhe nga toka e etërve, nëpërkëmbjen dhe rrezikun e shfarosjes, urinë dhe etjen. Janë situata që përsëriten në historinë e njerëzimit e jo vetëm në një popull. Në gjendjen në të cilën jetojmë mund të themi se elementë të kësaj errësire janë të pranishëm edhe në jetën e popujve në kohën e sotshme. Varfëria dhe uria po vret shumë jetë njerëzish, konfliktet e armatosura në shumë anë të globit, terrorizmi me matricë fetare, dukja në horizont e një konflikti nuklear, gjenocidi nëpërmjet abortit, ndarja e familjeve në botën moderne, e shumë dukuri të tjera, duket sikur po e çojnë botën në një drejtim të panjohur.

Po ashtu, në realitetin tonë shqiptar, duket se shumë dukuri errësojnë atë të mirë që çdo ditë, edhe pse në heshtje, hedh farën e saj në jetën tonë. Në shumë anë të Shqipërisë ka varfëri dhe mjerim, sidomos në zonat më

periferike të vendit, në fshatrat e braktisura, por edhe në periferitë e qendrave të mëdha urbane. Shpesh jetohet nën minimumin jetik. Kjo ka bërë që rreth 50 % e shqiptarëve, sipas statistikave, të dëshirojnë të ikin nga Shqipëria për një jetë më të mirë e më të dinjitetshme, duke zbrazur kështu kombin. E kjo vjen si pasojë e mungesë së shpresës. Errësira është mungesë shprese. Korrupsioni, pasurimi nëpërmjet kultivimit të lëndëve narkotike, papunësia, etj. bëjnë që hendeuku midis të varfërve dhe të pasurve, të fortëve dhe të dobëtëve, të bëhet gjithnjë e më i madh e të thellohet gjithnjë e më shumë.

Por *errësira* është akoma më shumë se sa kaq. Ajo është mospërgjigja dhe refuzimi i njeriut (Gj 1,11) ndaj planit të Zotit, i cili do që në tokë të përmbushet ligji i dashurisë midis njerëzve. Errësira është pasojë e zgjedhjeve të shtyra nga egoizmi dhe nga dëshira për pushtet e përfitim me çdo kusht e në kurriz të të tjerëve, e padrejtësive që bëhen çdo ditë prej atyre që mendojnë se kanë pushtet dhe fuqi.

E çfarë është drita?

Drita është prania e Hyjit dhe e çdo gjëje të mirë që ai ka vendosur në zemrën e njeriut dhe në jetën e botës. Është etja për paqe e drejtësi, pasi Mbretëria e Hyjit është mbretëri paqe dhe drejtësie (Rom 14,17). Është shpresa se njeriu mund t'ia dalë dhe se Zoti nuk e braktis. Profeti Isaia duke lexuar historinë me sytë e Hyjit e kupton shumë mirë se Zoti nuk e braktis kurrë popullin e tij dhe se fara e së mirës që ai ka mbjellë në botë (Mt 13,1-9) do të lindë e do të rritet.

Në të njëjtin libër që mbanë emrin e Isaisë thuhet: “Thuajuni atyre që i ka lëshuar zemra: “Mbahuni! Frikë mos kini! ... sytë do t'u çelen të verbërve veshët e të shurdhërve do të dëgjojnë; atëherë i shqepti do të kërcejë si dreri gjuha e të pagojit do të shpërthejë në hare, se në shkretëtirë do të burojnë ujërat, përrënjtë do të rrjedhin nëpër shkretëtirë.” (Is 35, 4–6)

Edhe ne si popull ia kemi dalë në shumë raste e përsëri me ndihmën e Zoti dhe angazhimin tonë të sinqertë mund t'ia dalim.

Janë bërë shumë gjëra të mira në këto vite në Shqipëri e për këtë duhet të falënderojmë Zotin. Ka shumë burra dhe gra që punojnë seriozisht dhe me përkushtim, qoftë në sektorin publik e qoftë në atë privat. Ne si ipeshkvij e inkurajojmë këtë gjë e japim kontributin tonë si bashkësi e krishterë katolike, bashkë me shoqërinë, për të mirën e vendit tonë.

Edhe ne jemi të angazhuar si Kishë, nëpërmjet shumë veprave dioqezane e famullitare, që t'u vijmë në ndihmë familjeve dhe individëve me probleme të varfërisë, të aftësisë së kufizuar, të grave të dhunuara, të familjeve të pamundura. Kemi ndërtuar dhe administrojmë në këto vite shkolla të të gjitha niveleve, kopshte, çerdhe e qendra shëndetësore që ofrojnë një shërbim të rëndësishëm dhe cilësor. Ndoshta mund të bëhet edhe më shumë e ne jemi të gatshëm të angazhohemi që kjo të ndodhë, kudo dhe kurdo të jepen mundësitë.

Por mbi të gjitha jemi të angazhuar që të kumtojmë fjalën e Zotit e cila është një fjalë shprese dhe drite. Krishtlindja është shfaqja e dashurisë së pamasë të Zotit për njeriun dhe për botën: “Hyji aq fort e deshi botën saqë dha Birin e tij një të vetmin (Gjn 3,16)”. E Ai, Krishti, për të gjithë ata që ecin në terr dhe në hijen e vdekjes, bëhet dritë dhe udhërrëfyes.

*Gëzuar Krishtlindjen dhe Vitin e Ri 2018
Ipeshkvijtë katolikë të Shqipërisë.*



Don Gjovani KOKONA
Kanada

BUKURIA E THIRRJES

Dëshira njerëzore për të qenë dikushi!

Ai që do të gjejë kohë e dëshirë të lexojë këto rrjeshta të jetë i sigurt se nuk do të gjejë këtu ndonjë shkrim poetik për arsye se ai që i ka shkruar nuk është ndonjë njeri i penës.

Arsyeja që më shtyu të shkruaj është qëndrime, bisedime me meshtarë e rregulltare gjatë vizitave të fundit në Shqipëri.

Në rradhë të parë zbulova te ta pasionin e thirrjes dhe të përkatësisë ndaj Krishtit! Në një atmosferë të sotme ku shpesh moskuptuesit e një thirrje janë vetë të pagëzuarit, kjo përkatësi më ngjalli admirim. Djem e vajza që pasi kanë gjetur “thesarin e fshehur në arë”, kanë “shitur” gjithçka kanë dhe e kanë “blerë arën”. Janë treguar të mençur që kanë bërë gjithçka në qetësi e heshtje deri sa e kanë “blerë atë”, e të mos ua kishte marrë dikush tjetër nëse do të bënin zhurmë e gjurulldi.

Dhe në një heshtje të vazhdueshme me Autorin e thirrjes, këtë thesar vazhdojnë ta ruajnë. E ky thesar i transformon që të jenë thesarë për të tjerët. Kjo është një mrekulli që vetëm Autori i thirrjes, Thesari i vërtetë, di të bëjë. Vetëm Ai di sesi të thërrasë disa *mëkatnorë ndërmjet mëkatnorëve për tu shërbyer mëkatnorëve*.

Në të njëjtën kohë zbulova që këto thirrje nuk ishin si një oaz në shkretëtirë, por dilnin nga një kopsht i bukur që vetëm dora e një kopshtari plot pasion mund ta bëjë, ky kopsht ishte realiteti shqiptar ku ata lindën dhe u rritën. Ata lindën gjatë orës tragjike në Gjetsemani. Ata lindën falë lutjeve të atyre Marive që qëndruan pranë kryqit, falë lutjes të asaj Kishe që nuk e mohoi Kryqin.

E ndërsa shihja me admirim këtë entuziazëm të Ringjalljes më ra ndërmend se lufta akoma nuk është e fituar. Këto janë si ato ditët me diell pas një furtune shiu e breshëri, që nuk do të thotë se furtuna nuk mund të rikthehet. E

për tu bërë ballë furtunave të tjera vijnë ndërmend fjalët: “Unë e kam fituar botën”.

E shenja furtunash që vura re janë ato të Izraelit në liri. Lodhja, thashethemet, gjykimet, paragjykimet. E këto vijnë qoftë nga ambjenti i jashtëm: në fakt jeta e meshtarëve/regulltareve është në sytë e çdokujt qoftë për mirë qoftë për keq; por vijnë edhe nga ambienti i brendshëm.

Dëshira njerëzore për të qenë dikushi nëse arrin të mbizotërojë jetën e dikujt bën që të sjellë pasoja të dëmshme në marrëdhënie me të tjerë. Tundimi i atij që lutet: të falenderoj o Zot që nuk jam si ky tagrambledhës, është/bëhet edhe tundimi ynë. Sigurisht këtu ndikon edhe mungesa e një udhërrëfyesi/udhëtreguesi. Në një ushtri të dobët edhe një ushtar i fortë rrezikon të rrëzohet, por në



një ushtri të fortë edhe një ushtar i dobët mund të arrijë të mos dezertojë. Një pjesë e udhëtreguesve të këtyre të rinjve e të rejave vinin nga ambiente kishtarë e/o shoqërore ku mungesa e entuziazmit dhe thatësira shpirtërore kishte filluar me vite të mbizotërojë (me një lule s'vjen pranvera...). Prandaj vlen gjithmonë këshilla: sa më shumë ngrihesh në detyrë, edhe më shumë ke nevojë të përparosh në përvujtëri. Sa herë ndodh që meshtarë/rregulltarë të devotshëm mbas ngritjes në detyrë bien në mediokritet dhe në shqetësimin për arritje të një suksesi tokësor. Sepse pesha e detyrës, shqetësimet që ajo sjell, vështirësitë materiale për përmbushjen e detyrës; të gjitha bashkë mund të sjellin humbjen e energjive dhe shtimi i mungesës së një jete të brendshme lutjeje sjell edhe degradimin shpirtëror. Mesha bëhet një praktikë e zhurmshme e çoroditëse. Çdo lutje bëhet thjesht një praktikë e jashtme dhe breviari, rruzarja një përsëritje e nxituar si diçka për tu thënë. Kështu bëhesh i dëmshëm për vetveten dhe rrjedhimisht edhe për të tjerët. Të tjerët llogjikisht presin nga i thirruri tu flasë për Krishtin, për Zotin; tu sjellë kujtesën e Jezusit, praninë e Tij. Për çfarë duhet kripa që e ka humbur shijen apo drita që nuk ndriçon më. Por duke iu rikthyer lodhjes në “liri” dhe pasojat e saj të dëmshme, mund të them pa frikë se rritja e një jete të brendshme të propozuar nga Ungjilli sjell qetësinë e brendshme, qetësinë shpirtërore dhe qetësia e brendshme (*interior silence*) e qetësia shpirtërore sjell fundin e gjykimeve, pasioneve, dëshirave. Kjo qetësi të

mban të qëndrueshëm në identitetin e thirrjes që ke. Pascal shkruan: “I gjithë trishtimi te njeriu vjen nga një akt i vetëm, nuk mund të rrinë në qetësi/heshtje në dhomën e tyre”. Zhurmat e ndryshme që na rrethojnë apo edhe aktivitetet jo të paraprirë nga një jetë heshtje e brendshme bëhen të rrezikshme sepse është një ilaç mashtrues që na nxit të shmangim ballafaqimin e vetvetes me boshllëkun tonë të brendshëm.

Tundimi që sjell boshllëku shpirtëror dhe mungesa e formimit njerëzor që në rritje në familje, ka pasoja të dëmshme. Një meshtar, motër apo ipeshkëv që bëhet si ajo fjala popullore: si “gratë e këqija”, që rrinë duke marrë nëpër gojë apo duke ju shpifur dikujt, e kanë marrë veten e tyre në qafë për shkak se nuk janë më në gjendje të shohin as bukurinë e thirrjes së tyre, dhe aktiviteti i përditshëm kthehet në një tentativë për të mbushur boshllëkun apo mungesën e formimit që përmenda më sipër. E rezultati i kësaj tentative të fundit është negative sepse, edhe pse mund të krijojë një lloj përmbushje apo kënaqësie, nuk është i qëndrueshëm në kohëzgjatje.

Duke e mbyllur i ftoj ata që do ti lexojnë këto rrjeshta që të mos mi marrin për keq, pasi unë që në thirrjen time jam, gati gati si thotë shën Pali, si një abort; frymëzohem në këtë thirrjen time të brishtë nga këta *alter Christus* të cilët nuk i josh bota me marrëzinë e saj por qëndrojnë besnikë duke u bërë ajo fara e mirë e mbjellë që vetëm duke vdekur jep fryte diku tridhjetëfish diku gjashtëdhjetëfish e diku njëqindfish.



Giovanni CUSSI S. I.

ÇIFTI DHE SFIDAT E KOHËS

(Pjesa II)

Roli i vështirësisë në fazat e kaluara të jetës në çift

Natyrisht, bëhet fjalë për elemente qarkore : sa më shumë që lidhja është e kënaqshme dhe është e formuar mbi njohjen efektive të partnerit/partneres, aq më shumë do të jetë e lehtë që të gjejmë pika takimi dhe do të vlerësojmë pikat e ndryshme të të shikuarit të ngjarjes. Në këtë rast, vështirësitë e hasura nuk do të

dëshira reciproke e të kundërshtuarit të njëri-tjetrit, dua të jap mesazhin se lidhja është më e rëndësishme sesa problemi/et. Një nga sfidat më delikate rreth kësaj teme, është aftësia për të vënë re mundësinë e të vlerësuarit ndryshe të partnerit/es. Kur bëjmë një gabim, mundohemi që ta justifikojmë me arsyeime të



jenë shkak i ndarjes, por i sfidave, ajo mbyll mundësi të reja që mund të na krijojnë, duke kontribuar mbi cilësinë dhe shëndetin e çiftit : “ Nëse jetojmë një lidhje të lumtur, të provojmë që të nënvizojmë rëndësinë e aspekteve pozitive dhe të nënvleftësojmë atë të aspekteve negative, ndërkohë, nëse lidhja na bën që të ndihemi të palumtur, bëjmë të kundërtën. Kjo tendencë është e rëndësishme, pasi emocionet dhe sjelljet pozitive parashikojnë shkallën e kënaqësisë, – vlen të thuhet se aspektet negative kanë aftësinë që të shkatërrojnë një lidhje, më shumë sesa aspektet pozitive janë në gjendje t'i shpëtojnë”.

Konfliktet janë pjesë e jetës, kuptohet edhe të jetës në çift. Por, ato mund të jetohen dhe përballohen në mënyra të ndryshme, qoftë edhe sipas mënyrës sesi ato janë interpretuar, veçanërisht nëse në thelb qëndron

ndryshme, nga më të pavullnetshmet, si: shpejtësia, lodhja, mërzitja, të qenit sipërfaqësor. Kur bëjmë një gabim, ndodh që të bëjmë një gabim tjetër reciprok : ky gabim mund të lexohet ndryshe nga partneri, duke u cilësuar si një gabim i madh, që është bërë madje edhe me qëllim nga tjetri.

Duke e parë tjetrin si negativ, e nga ana tjetër duke e gjykuar veten si pozitiv, mund të lindin pasoja shkatërruese për çiftin : “ Kur shikimi drejt partnerit është kritik, kjo tregon që nuk është zhvilluar martesë, madje martesë nuk është më as një projekt ku mund të këshillohemi së bashku, me qetësi, kuptim, tolerancë dhe bujari. Kjo bën që dashuria të zëvendësohet pak nga pak me një vështrim të pamëshirshëm, tashmë kontrollohen meritat dhe të drejtat e secilit, nga protestat, nga vetëmbrojtja që ato bëjnë”. (Al218).

Këtu duhet të shtojmë ndryshimet e të vlerësuarit nga psikologjia mashkullore dhe femërore. Ana femërore, përballë problemit, është më e lidhur me një kërkim global, mbi të gjitha me një risigurim; ndërsa burri mundohet të përqendrohet mbi detaje dhe, përballë një vështirësie, shqetësohet në gjetjen e një zgjidhjeje praktike. Ky ndryshim shfaq pasojat e dukshme edhe në planin e komunikimit. Burrat flasin vetëm një herë, gratë i thonë të gjitha bashkë, megjithatë të dy komunikojnë. Aftësia për t'u ndalur dhe për të gjetur kohën së bashku për të rilidhur udhëtimin e tyre të përbashkët jetësor, duke theksuar mënyrën e të shikuarit të gjërave, është mjaft e rëndësishme. Kjo mënyrë na stërvit sesi të punojmë me motivimin reciprok.

Fryti më i bukur që mund të lindë nga ky kuptim, është mundësia për t'u falur dhe falur. Afërsia afektive na ndihmon që të falim.

Falja, edhe pse shpesh, në fillim, duket e vështirë, padyshim që ndihmon në jetën në çift dhe forcon lidhjen. “Një sondazh i shkurtër që është zhvilluar në USA nga fundi i shekullit të kaluar, ka dokumentuar se çiftet lumturisht të martuara, nga më shumë se 20 vite, mendojnë se falja është një nga dhjetë faktorët që kanë kontribuar në jetëgjatësinë dhe mirëqenien e martesës së tyre...”. Kjo është e mundur, pasi falja na sjell si personin që e jep ashtu edhe atë që e merr, pra me pak fjalë, njerëzit nuk duhet të mendojnë vetëm për vete, por duhet të mendojnë edhe për partnerin/en, për lidhjen në të cilën janë përfshirë. Kështu, çiftet që falin tentojnë që të jenë më pak agresiv, duke adoptuar modele komunikimesh më konstruktive.

Të kultivosh një sjellje do të thotë të hysh në optikën e më të mirës së mundshme të çiftit dhe të familjes, duke shkapërcyer pozicionimet vetjake, të kundërta, që e minojnë që në rrënjë lidhjen.

Rëndësia e vlerave

Zakonet vendimtare për një lidhje të një periudhe të gjatë mund të rimerren në kategorinë më të zakonshme të lidhjes. Pak më lart folëm për nivelin e lidhjes dhe të kënaqësisë së marrë nga ajo, dhe sa më mirë të funksionojnë këto dy pika, aq më e madhe do jetë qëndrueshmëria e çiftit përgjatë kohës. Dashuria duhet të shikohet në aspektin e ndjenjës dhe jo si emocion, i cili ndonëse është i thellë, ka një kohëzgjatje të shkurtër : të jesh i ndjeshëm shpreh më mirë vetveten, por kur ndjenja është e bashkuar me njohjen, vullnetin dhe vlerat, bëjnë që dashuria të jetë e mirëfilltë. Ky është motivi pse në Ungjill dashuria është paraqitur si një urdhërim.

Dashuria mund të komandohet : kjo gjë nuk e mohon përdorimin që bëri Perandori « Më duaj ! ». Ajo është e bashkuar me vlerësimin dhe me ndjenjën që kemi dhe është e aftë që të shtyjë të dashurin që të kryejë aq sa të mundet ai dhe kjo gjë nuk mund të komandohet kurrë nga ndonjë ligj. Siç e tregon me finesë F. Rosenzweig : “ A mund të komandohet

dashuria”? Komandimi i dashurisë mund të vijë vetëm nga ana e të dashurit/ës. Vetëm i dashuri, mund të thotë dhe në fakt thotë: “Më duaj!” Në gojën e tij, komandimi i dashurisë nuk është një komandim i padëgjuar, por është veçse vetë zëri i dashurisë.

Bëhet fjalë për një dashuri të integruar, e jo një dashuri që i limitohet një pasioni kalimtar, apo një akti të dëshirës: është ekspresioni më i bukur dhe i qëndrueshëm që mbledh vlerësime, ngrohtësi dhe vendosmëri, deri në pikën e të qenit të aftë për të dhënë vetveten. Kapaciteti i integritetit të hapësirës së ngrohtësisë është shumë i vlershëm dhe vendimtar për zgjedhjet e jetës, për ndershmërinë ndaj tyre dhe aftësinë për t'u përfshirë thellësisht, për të dashuruar dhe për të qëndruar në dashuri, duke përballuar situata kur të bëhen më të paparashikueshmet, frustruese, konfliktuale dhe të lodhshme zgjedhjet që duhen bërë. Tjetri dashurohet, jo vetëm për shpërblimin që mund të marrë, por pasi ai/ajo tregon një ndershmëri që e kalon fazën e të dashuruarit me një shikim, apo të një simpatie sipërfaqësore, ai bëhet i gatshëm që të ruhet në të tilla zgjedhje, duke përballuar zgjatjen dhe vështirësitë e kohës.

Dashuria mund të jetë pasoja e një lidhjeje dhe e një vendimi që i lejon për të qëndruar bashkë përgjatë kalimit të viteve. Nga ana tjetër kjo është edhe dashuria që fëmijët kërkojnë nga prindërit e tyre, të kihet një lidhje: që ka kohë, është e qëndrueshme, personale dhe unike. Pa një ndjenjë të tillë ato ndihen të privuar nga mosha e tyre dhe nga mungesa e kapacitetit për të dhënë besim, veçanërisht që të fiken për diçka të bukur.

Roli i komunitetit

Përhapja e lidhjes së jetës në çift, është pa dyshim, më e shpërfillur nga kultura e imagjinuar, dhe më e dashura e shoqërisë sonë. Bëhet fjalë për një devijim të vështirë për shëndetin e familjes, e përmendur bukur tek *Amoris laetitia*. Papa Françeko, na tregon një tendencë spontane që mund të bëhet e dëmshme për çiftin, zbehjen e hapësirës publike: “Rrjeti i vogël nuklear i familjes nuk duhet që të izohet nga familja e larguar, nga prindërit, xhaxhallarët, kushërinjtë dhe nga fqinjët. Në këtë familje të largët, mund të jenë disa që kanë nevojë për ndihmë, apo vetëm për shoqërim dhe gjeste me dashuri, apo mund të jenë njerëz me vuajtje të mëdha, të cilët kanë nevojë për një konfrontim. Individualizimi i këtyre kohëve, ndonjëherë na çon që të mbyllemi në ngrohtësinë që na jep një fole e vogël, ose të perceptojmë të tjerët si një shqetësim të vogël. Megjithatë, një izolim i tillë, nuk na jep më paqe dhe lumturi, por e mbyll zemrën e familjes dhe e privon nga hapësira e ekzistencës” (AL 187). Mbi bazën e punëve hasim dy aspekte thelbësore: që ajo është e konceptuar si e revokuar dhe mundësia për t'u fikur për këtë besueshmëri. Në një rast të tillë, zgjedhja që bëjmë mund të bëhet burim i lumturisë dhe i sodisfaksionit, për veten dhe për tjetrin.

Hapësira publike e martesës është zhvlerësuar

tërësisht në Lindje, pasi kishin një vështrim krejt romantik të jetës në çift. Dashuria romantike ka pasur patjetër meritën e rivlerësimit të rëndësisë që ka ndjenja në zgjedhjen martesore, duke e kontestuar tendencën dhe duke e transformuar në një çështje ekonomike, apo si aleancë politike. Por, nëse provohet nga aspekti i saj institucional, lidhja bëhet shumë e dobët për të arritur që të përballojë vështirësi të tilla. Vetëm pasioni nuk mjafton për ta, që ta lejë në jetë dashurinë. Ky vizion i dashurisë është në realitet një iluzion i rrezikshëm, shpejt do të largohet nga faktet: “Raportet janë disa ndërtesa, dhe si të gjitha ndërtesat që nuk mbahen dhe nuk përmirësohen, i nënshtrohen përballjes me kohën. Ashtu siç nuk do të presim kurrë që një ndërtesë të mbahet vetëm me anën e kushteve të mira, ashtu nuk mund të presim që një raport dashurie të mbahet në këmbë vetë: jemi ne ato që duhet të mbajmë përgjegjësinë për të bërë gjithnjë e më shumë gjëra të mira”.

E gjitha kjo është e shkëputur nga të njëjtët shkrimtarë romantik; personazhet e tyre shkojnë gati gjithnjë në një takim me vdekjen, apo kanë një përfundim tragjik, siç u pa; vdekja konsiderohet si një dalje e sigurt nga jeta e vështirë ordinere. Idealizimi i ndjenjës ka bërë që të paragjykojë qëndrueshmërinë e takimit, duke i bërë të dashuruarit jo vetëm më të pasigurt, por edhe më të palumtur.

As vdekja e tjetrit/tjetrës nuk mund të na sjellë qetësinë e kërkuar: prezenca e brendshme e tij vazhdon ta përndjek atë që ka mbetur. Nuk ndihemi aspak të liruar kur vdes partneri: krejt e kundërta, na mbetet një trishtim i panjohur për atë që ka ndërtuar një lidhje të lumtur. Është një tjetër aspekt paradoksal i jetës mbi tokë: kush ka jetuar një lidhje të bukur dhe të përmbushur e vuan më pak humbjen e bashkëshortit, në raport me atë që kishte jetuar një lidhje të trishtuar dhe konfliktuale. Në këtë rastin e fundit, duket që del bashkë me dhimbjen e humbjes dhe keqardhja e shpenzimit të mundësive të rëndësishme të jetës së vet, që mund të ishin jetuar në një mënyrë tjetër.

Familja ka një dimension institucional që nuk mund të heqësh dorë, e jo vetëm për hir të shoqërisë, por edhe për vetë bashkëshortët. Për këtë, nxitja që i drejtohet komunitetit kishtar, për të mos braktisur nga vetja e tyre çiftet, qoftë duke marrë dhimbjet e atyre që kanë parë të thyheshin një ndër lidhjet më të fuqishme të jetës, ose qoftë duke e shoqëruar në mënyrë efikase atë që dëshiron të përgatitet për martesë, në një mënyrë të vetëdijshme. Grupet e familjeve kanë në këtë gjë, një rol të çmuar dhe të pazëvendësueshëm. (Crf AL206, 230).

Dimensioni i lidhjes në martesë është e lidhur me vizionin e dashurisë si një komandim, në kuptimin e thënë më lart. Në këtë paradoks, është i mbyllur një mësim vendimtar, që mund të rregullojë çekuilibrin e mentalitetit lindor. Një ndihmesë për të rivlerësuar vlerësimin mund të marrim nga kulturat e ndryshme evropiane, në të cilat martesë është fryt i një

pune, dhe së bashku është një ideal i bukur për të cilin ia vlen që të shuhemi. Kjo u bë mundur nga familjet e ardhura, të cilat kanë një rol shoqërues me çiftin e ri, që në të vërtetë dhe ato kanë mësuar nga prindërit e tyre se çfarë do të thotë të duhesh dhe të përballosh bashkë vështirësitë e jetës.

Dëshmia e një nuseje indiane që po e sjellim këtu, mund të na duket e largët nga mentaliteti perëndimor, por në të vërtetë ajo na rrëfen një të vërtetë të çmuar, shpesh herë të përmendur në këto faqe. Lidhja mund të gjenerojë një dashuri, e cila është e aftë që të japë qëndrueshmërinë e saj, duke i lejuar çiftit që të provojnë një kënaqësi që zgjat në kohë: “Ne e bazojmë martesën tonë në angazhimin e prezantuar nga premtimet martesore, jo mbi ndjenjat. Hap pas hapi që martesë jonë ec përpara, zhvillohen edhe ndjenjat. Nga ana tjetër, kur martesë bazohet në ndjenja, çfarë ndodh kur ato zbehen dhe pakësohen? Nuk na mbetet më asgjë që ta mbajmë martesën e lidhur. Dashuro me mendje dhe me zemër!

Përktheu: Bernardina Shahini

Material i përkthyer nga revista kulturore – fetare “*La civiltà cattolica*”, 2017.



Dom Lush GJERGJI

Prishtinë

GIORGIO LA PIRA

(1904 – 1997)

“Gjithë të krishterëve i është barrë e ndershme të punojnë për njohjen e porosisë hyjnore dhe atë ta pranojnë të gjithë njerëzit çdo kund në tokë”.

(AA 3)

“Të jesh apostull në botë e të mos jesh nga bota dhe të mos jesh i pranuar nga bota... Ndërroni ligjin, sepse unë nuk mund ta ndërroj Ungjillin.”

Giorgio la Pira

Giorgio La Pira u lind në Pozzallo (Ragusa) në vitin 1904 në një familje tradicionale katolike. Fëmijërinë e qetë dhe të këndshme e kaloi në vendlindje. Si fëmijë ishte i bukur, shëndoshë, mençur, i dhënë pas mësimi, leximit, shkrimit, hulumtimit, në vëzhgim të kujdesshëm të rrethit. Daja Luigi e mori me veti në Messina, që atje të studijonte kontabilitetin. Pas një kohe regjistroi edhe drejtësinë. Përveç studimit Giorgio lexonte shumë, mendonte, lutej, kërkonte gjithnjë diçka më tepër....

Thoshte: „Do të dëshiroja të isha sikur rregulltar kartuzian në rrugët e botës.“

Literatura e pëlqyer për lexim, ishte Bibla dhe Etërit e Kishës. Në veçanti e deshi Tomë Akuinin. Aty zbuloi pasuri të pafund dhe visarin e fshehtë, të cilin dëshironte t'iu përcillte edhe të tjerëve, të gjithëve. Për këtë zgjodhi rrugën e apostullit laik, për të pasur mundësi me vetëdijen dhe detyrën e krishterë të jetë mes njerëzve

dëshmitar burimor i Ungjillit.

Rreth vetit filloi të mblidhte rininë, e cila ishte e varfër shpirtërisht dhe materialisht, për t'i informua dhe formuar. Metodologjia i ishte ajo e Shën Vinçenc Paulit dhe Konferencave të tij, apo të Aksionit Katolik.

Angazhimi fetar, shoqëror dhe politik

Moto dhe frymëzim për veprën ungjillore ishte: të përtërisht gjitha në Krishtin! Në vitin 1934, filloi të mblidhte rininë rreth Eukaristisë. Qe pjesëmarrës në meshën e shenjtë në Shën Procolo, ku së shpejti do të jetë edhe pikënisja e veprimtarive të shumta.

Duke jetuar në kontakt me varfërinë, braktisjen, mosdijen e rinisë, La Pira vendosi t'i kushtohet politikës, që me këtë t'i ndihmojë rinisë, popullit, dhe t'i shërbejë të mirës së përgjithshme.

Lufta e Dytë Botërore, pati rrënuar thuajse gjithçka



në njeriun, në familje, në shoqëri. Varfëria, u shndërrua në mjerim, shkatërrim dhe rrënoja. Njeriu i thjeshtë, i vogël, pa emër ishte i shkelur nga vështirësitë e shumta dhe se nuk dinte se si të mbrohet, si të organizohet.

Giorgio La Pira shkruan, studion, punon natë e ditë rreth Kushtetutës së re të Italisë, që së paku në letër të jetë i vendosur mirë dhe drejtë legjislacioni njerëzor dhe e krishterë.

Në vitin 1948 Giorgio La Pira që i zgjedhur në Parlamentin italian si nënsekretar operativ në hartimin e Kushtetutës së re. Si gjithmonë jepte gjithë nga vetvetja, punonte, kërkonte zgjidhjen më të mirë për botën e varfër. Njerëzit shumë shpejt hetuan shërbimin e La Pira, kështu që ai edhe më tepër fitoi besimin dhe simpatinë e popullit.

Në vitin 1951 Giorgio La Pira u zgjodh kryebashkiaku i Firencës. Si qytetari i parë, punonte për të mirën e popullatës, të njerëzve të thjeshtë dhe të varfër, merrej me çështjet e banimit, shtëpive, punës, punësimit, studimit, shëndetësisë, historiatit të qytetit, me një fjalë me gjithë atë që do të duhej dhe mund t'u ndihmonte për të jetuar më mirë, në qetësi dhe harmoni me të gjithë. Ai e do Firencën dhe popullatën e saj: *“Firencë, e ëmbël dhe e dashur e imja, e krijuar së bashku prej Zotit dhe njeriut, për të qenë si qyteti i ngritur në Mal, dritë dhe ngushëllim në rrugët e njerëzimit.”*

Përpos angazhimeve politike për popull, për qytetarë, si kryebashkiak i Firencës, ai është edhe kozmopolit, ka një mendje dhe shpirt të shëndosh, zemër të madhe dhe plot dashuri të cilën u dhuronte të gjithëve. Udhëtonte shumë për t'u takuar me popuj të ndryshëm, të mësonte nga të tjerët, që të bëhet urë, ylber i paqes dhe dashurisë. Arriti edhe në Bashkimin Sovjetik, në Vietnam, në Lindjen e Mesme, në pjesë të ndryshme të Afrikës dhe të Azisë. Nga kjo përvojë erdhi deri te përfundimi se paqja iu takon të gjithëve, sepse të gjithë ne jemi një familje njerëzore.

Giorgio La Pira jeton, punon, angazhohet, sepse beson në vlerat themelore, shpreson në botë më të mirë, por mbi të gjitha dashuron, dhe pikërisht për këtë është pjesëmarrës në “fatin” e njeriut dhe të njerëzimit.

Gjatë një fjalimi në Këshillin Komunal në vitin 1954 tha: *“Detyra ime themelore është kjo: mos të lejoj diskriminimin. Këtë detyrë e kam para se të bëhem kryebashkiak, pra, si udhëheqës i një familjeje solidare qytetare – këtë e kam edhe si i krishterë; kjo ka të bëjë qenësisht me hirin dhe Ungjillin! Nëse vuan ndokush, unë kam detyrimin e qartë të intervenoj në të gjitha mënyrat dhe me mendjemprehtësinë time e cila propozon dashurinë dhe mundëson ligji, që ajo vuajtje të pakësohet apo zbutet... Unë nuk jam i krijuar për politikë, për jetën politike në kuptimin e plotë të këtyre fjalëve: nuk e dua dhëlpërinë e politikave, dhe premtimet e tyre zgjedhore: e dua të vërtetën e cila është sikur dritë, e cila është shenjë e i rëndësishëm i dashurisë; kam dëshirë t'u tregoj njerëzve si qëndrojnë*

punët: të mirës t'i them mirë, e të keqes e keqe... Tentoj ta bëjë Firencën oazë të paqes së krishterë, ku do të kenë mundësi të gjejnë shpresën dhe miqësinë pa përjashtim të gjithë popujt e tokës...”

Rruga e gjatë fetare dhe intelektuale

Si erdhi Giorgi La Pira deri te këto bindje dhe përcaktime politike, fetare, kulturore e shoqërore?

Në kërkim të vazhdueshëm përmes fesë, përmes përvojës së jetës së krishterë. Mbi apostolatën e laikëve qysh në vitin 1937 shkruante kështu: *“Apostulli, laiku në vendin dhe kushtet ku e cakton Zoti, është i fuar të realizojë planet e Zotit dhe të Kishës; ai duhet të jetë mjet i besueshëm i kësaj Kise: kurrfarë interesi nuk duhet të robërojë shpirtin tim. Apostulli, laiku, pra, nuk ka zotëri tjetër pos një Zotëriu, Zotin, vetëm një qëllim, Zotin, vetëm një dashuri, Zotin, vetëm një ambicie, lavdin e Hyjit dhe Kishës...”*

Për Giorgia La Pira apostollati që i përhershëm, përkushtimi i vetëdijshëm dhe sinqertë në të gjitha rrethanat dhe në të gjitha fushat e punës dhe jetës. Pas që doktori në drejtësi ai u bë edhe profesor universiteti. Edhe kjo detyrë mësimdhënie është apostollat, dërgim i madh dhe rëndësishëm për të krishterët. *“Detyra e jonë edukative – sa fatlumtësisht parashohin kriteret e reja edukative me të cilin është i frymëzuar ky sistem – që priret për formimin e njeriut në tërësi; sa e madhe është detyra e jonë, që përmes edukimit të mendje të kuptohet dhe pranohet se jeta, të cilën na ka dhuruar Zoti, është dhuratë me vlerë të paçmueshme. Duke iu drejtuar rinisë e thash këtë: 'Ja ka na drejtojnë përpjekjet tona. Ka kjo: që të jeni të vetëdijshëm për këtë pasuri të paçmuar, të cilën iu dhuroi Zoti: jetën!’”*

Dëshira dhe obligimi i Giorgio La Pira-s, në mësimdhënien e tij në universitet për studenten, ishin të jetë mik-vëlla-atë, edhe më tepër, mësues i jetës dhe fesë. Stili ishte i ri, tjetër, i drejtpërdrejt, i përzemërt; përmbajtja, porositja ishin ngushtë të lidhur me jetën konkrete, gjersa studimi ishte rast për takime, për pasurim dhe dhuratë të ndërsjellët. Kështu ai shumë shpejt fitoi simpati dhe nderim edhe në mesin e universitetit.

Vitet e luftës

Fashizmi dhe lufta shkatërruan pamëshirshëm të gjitha këto ëndrra dhe dëshirat e të rinjve. Realiteti i përditshmërisë ishte i rëndë, i dhembshëm, i pamëshirshëm, jonjerëzor.

Giorgio La Pira nuk dorëzohej. Edhe në të “pamundshmen” e bënë të pamundurën dhe është plotësisht i qartë në vlerësime: *“Gjatë gjashtë viteve (që nga invazioni në Poloni në shtator të vitit 1939 deri te eksplodimi nuklear në Hiroshimë me 6 gusht 1945) vërtet me gjak të pashkruar janë ngulfatur dhomat me gaz mbi gjashtë milionë hebrenj, dhe pati më se 20 milionë të vdekur; në një mënyrë u shkrua kreu i “fundit” i historisë botërore!... Pyetnim, pse ka filluar të fundoset anija e historisë? Sepse lundronte pa busull të vërtetë,*

me një busull krejtësisht të gabuar, antihistorike, antishkencore, antikristiane; ku në vend të paqes ishte urrejtja, në vend të bashkimit ndarja; në vend të paqes lufta; në vend të solidaritetit dhe barazisë mes njerëzve dhe popujve, pabarazia strukturore, diskriminimi strukturor (më të lartit dhe më të ultit) mes njerëzve dhe popujve...”

Ai, jo se vetëm ashpër gjykoj luftën, fashizmin, por shkoj një hap më tutje, dhe me ndërgjegje të krishterë vlerëson edhe historinë: “E vërteta është sikur drita; nuk e duron dot errësirën dhe mjegullinën...I krishteri nuk mund të jetë neutral; nëse ka të kështu, ai doemos duhet intervenuar që të përmirësojë pasojat e së keqes, kuptohet, aq sa është e mundur; përndryshe atëherë cili do të ishte kuptimi i urdhrit të dashurisë? Nëse e sheh vëllain e lënduar nga grabitësi (Lk 10, 30), unë kam për detyrë të ndalem e me dashuri t'i ndihmojë: më duhet të ndërmjetësoj që të përmirësojë pasojat e urrejtjes. Krishti ndërmjetësoi në dramën e dhimbshme të njeriut: dhe këtë gjest shëlbimi e pagoi me gjakun e vet, flijon e kryqit.”

Guximshëm dhe me plotë vendosmëri shkruan: “Parimi i parë: të gjithë njerëzit janë vëllezër; sepse të gjithë i krijoi një Zot i vetëm dhe i shëlbtoi i vetmi Shpëtimtar. Ja dritaret e hapura të shpirtit: janë të hapura të gjitha perspektivat e vërteta gjithëpërfshirëse...”

Përkushtimi i tij në politik ishte për shembull, krejtësisht tjetër (ndryshme) nga të tjerët, kështu që shpeshherë nxitu huti të caktuara, thuajse gati pabesi (mosbesim) në disa rrethe politike, kurse në shumë të tjerë ishte frymëzim për sjellje të ndershme, për shërbim në të mirë të përgjithshme të popullit...

Vetes sime, gjithmonë ia parashtroj këtë problem: “Krishterimi dhe jeta publike...Të gjithë njerëzit kanë të drejtën në jetë, punë, në dinjitetin njerëzor. Ky është krishterimi: të gjithë ne jemi të ftuar ta shqyrtojmë ndërgjegjen tonë. Qëndrimi ynë krishterë është aq i qartë, aq i thjeshtë, aq i vendosur. I kemi thënë 'jo' Mussolinit (edhe atë në farë kushtesh e rrethanash!), do ti themi gjithmonë 'jo' të gjithë atyre të cilët pavarësisht se nën farë preteksti, apo që nën petkun e ligjit, shkelin (cenojnë) të drejtën me të cilën fyejnë rëndë personalitetin njerëzorë, tempullin e Zotit jetë!”

Si një i krishterë i dalluar në politikë njëherë kështu sintetizoi programin e tij për qytetin e Firencës:

1. Punë për të papunët.
2. Shtëpi, për të pastrehët.
3. Kujdes, për nevojtarët.
4. Liria shpirtërore dhe politike për të gjithë.
5. Firenca-qytet i artit dhe përshpirtërisë në planin e përgjithshëm të krishterë dhe qytet njerëzorë.

Lajmëtar i paqes në botë

Giorgio La Pira, ka patur vizionin e përgjithshëm të jetës politike në shërbim të njeriut, kombit, të gjithë njerëzimit. Në veçanti, ka punuar rreth përafrimit të dy botëve të ndryshme, shpeshherë edhe konfliktuoze dhe

armiqësore, për shkak të sistemeve politike, pra, botës perëndimore – kapitaliste, dhe asaj lindore – komuniste. “Jo më, pra, Lindje-Perëndim të ndarë me blloqe të ndryshme, porse vëllazërisht të bashkuar përmes urës së shpresës dhe miqësisë.”

Shpeshherë dhe me kënaqësi është marrë me pyetjen e papunësisë. Ai përsëriste: “Të papunëve, punë, të pashtëpive, shtëpi, të sëmureve kujdes dhe trajtim, të gjithëve dinjitet njerëzor dhe të krishterë.”

Punoj dhe luti shumë edhe për paqe në botë, që nga Vietnami e deri për Rusi, Kubë...,kudo që kishte rrezik lufte.

“Të gjitha iniciativat të cilat synojnë tejkalimin e blloqeve dhe rrënime muresh të cilët ende ndajnë popuj e shtete na interesojnë thellësisht: pyetja e armatimit, pyetja e luftës dhe paqes, kjo do të thotë pyetje të kesh apo mos kesh qytete, viktima të pakompenzuara (të pakuperueshme) të luftës nukleare apo jo nukleare... Paqja dhe siguria – uniteti i Evropës nuk është vetëm çështje e kontinentit europian, por do të duhej të përfshinte tërë botën: nga ky kontinent – për të cilin është menduar se do të duhej të ishte pjesë (zonë) e konfliktit të dy blloqeve, dhe për këtë edhe pikënisje e frikshme e Luftës Tretë botërore – do të përhapet nëpër tërë botën duke zvogëluar tensionet, bashkëjetesa në paqe!...”

Giorgio La Pira, në mënyrë profetike njohu shumë probleme kyçe të botës, mirëpo edhe rrugët dhe mënyrat e zgjidhjeve të këtyre problemeve, për të arritur deri te paqja e vërtetë, drejtë dhe përhershme në mes të gjithë njerëzve.

Ja propozimi i tij për paqe: “Duhet tejkaluar blloqet; me këtë do të ndaleshin luftërat, në veçanti në Azi dhe në Lindjen e Mesme; çarmatimi nuklear (të gjithat deri te shkatërrimi dhe asgjësimi i tërësishtëm i tyre); promovuar politikisht vendet në zhvillim (zhvillimi është emri i ri i paqes): bashkëjetesë paqedashëse dhe të vërtetë (jo aso e cila themelohet në baraspeshën e frikës) në mes të gjithë popujve dhe shteteve të botës.”

Edhe pse ishte gjithnjë i angazhuar me politikë, kulturë, hulumtime shkencore, ai askurrë nuk e harroi punën për Kishë dhe në Kishë.

“Katolicizmi – kisha Katolike – nuk është e madhe dhe gjithëpërfshirëse nëse nuk është bashkësi, në të cilën është Krishti kreu (Koka) e papashme, kurse Pjetri kreu i pashëm; ajo anëtarësohet (përbëhet) nga një numër i madh i bashkësive eukaristike: njëra ndër to është edhe e jona.”

Duke komentuar enciklikën e papës Gjonit XXIII. *Pacem in terris*, La Pira shkroi: “Nuk mendoj se e teprojmë nëse themi se ajo është ‘manifest i botës së re’, manifest që thërret jo vetëm katolikët, të krishterët, besimtarët, por po ashtu të gjithë njerëzit vullnetmirë që të merren me mençuri dhe dashuri, secili atje ku e ka vënë Provania e Zotit, në ndërtim të veprës më të madhe dhe urgjente të cilën na ka besuar historia bashkëkohore: në ndërtimin e shoqërisë së re në paqe dhe ‘veshje të re’...Hyji nuk e frymëzoi kot Gjonin XXIII dhe porosinë e paqës të cilën e dha ai – në emër të Hyjit – të gjithë popujve.”

Mbi bashkimin e të krishterëve, ai i shkroi papës Gjonit XXIII. edhe këtë: „*Të premtën mbrëma më tha Patriku Atenagora I: 'Duhet t'i ndihmojmë Atit Shenjt, ne patrikët, sepse tashmë erdhi momenti për të rrugëtuar të gjithë së bashku: në këtë moment të rëndësishëm të historisë njerëzore'. Dhe shtoi: fuit homo missus a Deo cui nomen erat Johananes! Më tutje më tha: 'Bëjani me dije Atit Shenjt: dëshiroj të më pranoj; erdhi momenti i madhërishtëm!...' Nëse ekziston problemi spektakular politik, problemi spektakular i historisë – problem i problemeve! – atëherë ky është pikërisht problemi i bashkimit të Kishës! Kjo ishte dije, me ndërprerjen tragjike dhe të dhembshur të bashkimit; ky është problem i sotëm, me pritjet të lumtura dhe të buta për bashkim...*”



Vitin 1970, La Pira i shkroi letër Jaser Arafatit mbi problemet e Palestinezve duke shtruar pikëpamjen e tij rreth zgjidhjeve të konflikteve të mëdha në Lindjen e Afërt: “*Unë mendoj zotëri Arafat, se me të vërtetë jemi para agimit të historisë së re – një kërcimi kualitativ – dhe i politikës së re. Palestina shtet, sado të jetë i vogël, do të jetë fuqi e pamatshme politik, e e cila do të sjellë baraspeshë mes fuqive...*”

Pas vizitës në Moskë (1971) shkruan: “*Kam parë shumë shkaqe të dukshme për shpresë dhe hire në aq shumë shpirtra të rinj: atje kuptova se Zoti është në zemër...*”

Siç mund të shihet, nga këto pak shkëputje, nga jeta dhe puna e tij, Giorgio La Pira ishte çdo kund dhe gjithmonë i krishterë, katolik, edhe më tepër apostull laik, në shërbim të Zotit, Kishës, njeriut, çdo qenie njerëzore. Ai e ka kuptuar mirë historinë e shëlbimit, Krishtin, pikën qendrore, Alfën dhe Omegën e historisë njerëzore, pa të cilin nuk e mundëshme paqja, drejtësia, barazia, dashuria, ardhmëria, shëptimi, amshimi.

Giorgio La Pira ishte njeri i angazhimeve të gjithanshme, por në veçanti i dhënë për jetë të lirë, të përgjegjshme, dhe jetë të motivuar për individin, familjen, popujve të botës, për jetën si dhuratë – dërgim, që është dhënë dhe të cilën na duhet doemos t’iu dhurojmë edhe të tjerëve.

Në vitet e fundit të jetës së tij, vuajti shumë, si për shkak të sëmundjes, po ashtu për shkak të gjendjes italiane dhe asaj ndërkombëtare.

Me fuqitë e fundit, i shkroi Papës Palit VI: “*Është*

fakt se jeta të cilën e jetoj tashmë disa muaj, është e vështirë. Tani jemi në fund të muajit gusht dhe nuk më mbetet asgjë tjetër veçse të mendoj mbi këtë fakt, me dëshirë se jam duke shkuar në takim deri në fund të vullnesës së Zotit!”

Jetoi për atë ditë “*të vetme dhe të bekuar e cila nuk njeh perëndim*”. Vdiq më 5 nëntor 1977.

Papa Pali VI e kujton La Pir-in me këto fjalë: “*Jetoi varfërisht, në mesin e shumë botërave, pranë shumë pyetjeve dhe punëve, mirëpo gjithmonë me ideal, gati se thuajse ëndërrtar, që të arrijë këtë qëllim. Ai është person i cili ka patur gjithmonë ndjen për caqe, e jo vetëm për mjetet me të cilat udhëtohet, por edhe të vet udhëtimit. Kah? Ja ajo që na duhet gjithë neve, transformimi i mentalitetit”*

Në varrimin e tij, populli i Firencës u mblodh rreth tij sikur pranë atit dhe vëllait të tyre. Gazeta fiorentineze “*La Nazione*” shkruan mbi vdekjen dhe varrimin e tij kështu: “*La Pira, i takoi mesit të atyre njerëzve, të cilëve mund vetëm t’i mrekullohemi apo kundërshtojmë. Në të ishte mirësia e pamasë ndaj të afërmit, dhe origjinaliteti i caktuar, i cili ndonjë tjetër do ta sillte me mijëra herë në situata qesharake.*”

“*Kur pas përfundimit të Luftës Dytë botërore është përgatitur plani i rindërtimit të Europës, në të kishin pjesë, rol të rëndësishëm dy të krishterë, Alcide De Gasperi, dhe ajo fytyrë karizmatike i cili ishte kryebashkiak i Firencës, Giorgio La Pira*”

(Gjon Pali II, 1994).

Pierluigi BATTISTA

PAPA FRANÇESKU:

KURAJOJA PËR TË MARRË MBI VEhte FAJET E PERËNDIMIT

Më së fundi Papa Françesku, në zemrën e ciklonit birman e jo në dhomat vatikane, jo vetëm e përmendi popullin e përndjekur të Rohingiave, por u kërkoi atyre të falur. Falje për heshtjet, të pathënat, marifetet diplomatike, me të cilët demokracitë perëndimore kanë dashur të hedhin lumin përballë një spastrimi etnik të përbindshëm. Më së fundi Papa Françesku i përkuli qëndresat e atyre që i këshillonin maturi, t'atyre që e lutnin, për të mbrojtur paprekshmërinë e katolikëve dhe të krishterëve në përgjithësi në Birmani, të mos e përmëndëte atë emër të pashqiptueshëm. Duhej mbajtur një mbulesë heshtjeje mbi fshatrat Rohingya të rrënuara, mbi qindrat ekzekutime publike, mbi ikjen e më shumë se gjashtëqindmijë civilëve drejt strehimit të Bangladeshit për t'i shpëtuar përndjekjes, dallimit, vdekjes. Thuhet se arsyeja e një mizorie të tillë qëndron në veprimtaritë terroriste që ajo bashkësi myslimane mbulon. Por është e lehtë të kuptohet shpërpjestimi i kundërveprimit të Birmanisë së Aung San Suu Kyi : një spastrim etnik rrënues, të vdekur, tortura, kundërterror.

“Falja” e kërkuar nga Papa Françesku është kurajua për të marrë mbi vehte fajet e gjithë Perëndimit. Është një mësim për frikamanët, për të mefshtit, që n'emër të Realpolitikës, ose të frikësimit ekonomik, këshillojnë bashkëpunimin e tërthortë me masakruarit që duhen mikluar ose sidoqoftë nuk duhen kundërshtuar me qëndrime të pamatura. Kishte arsye shumë të mira për të cilat Papa mund e duhej të kishte vazhduar në këtë rrugë realizmi pëlqyes. Sepse një nga karakteristikat e atyre që masakrojnë një popull duke kërkuar një pandëshkueshmëri ndërkombëtare krejtësisht të pamerituar është edhe aftësia për të frikësuar botën. Përse ka shumë vështirësi në kancelaritë perëndimore për të pritur në formën e duhur Dalai Lamën, simbolin e një krahine të cilitur e të përgjakur në masakrimin e më shumë se një milion viktimave të pushtimit kinez? Sepse kundërveprimi i Kinës mund të dalë shumë i papëlqyer, edhe në



planin e marrëdhënieve tregtare : tiranët trajtohen me rreptësi vetëm kur ata nuk janë më në majën e pushtetit absolut. Me gjestin e tij Papa Françesku bën një kthesë në konsideratën ndërkombëtare kundrejt masakrave të popujve nga ana e qeverive të pandëshkuara. Edhe beteja për mbrojtjen e të drejtave themelore njerëzore do të ketë në anën e saj ndonjë municion më shumë. Sigurisht, do të ketë prirje për të zvogëluar, nënvleftësuar gjestin papal, për të harruar faqen e shkruar në Birmani. Ka të ngjarë që gjithshka të kthehet në rendin e përcaktuar të realizmit politik dhe të shkujdesjes morale të opinionit publik botëror. Por në planin simbolik fjalët e Papës, ajo sfidë e hapur dhe e deklaruar hipokrizive të qeverive, marrin një vlerë të pakrahasueshme. Nga ajo ditë qeveritë diktatoriale, që dhunojnë të drejtat njerëzore dhe vetë mbijetesën e pakicave të përndjekura, do të ndjehen më pak të qeta. Fama e tyre është e paracaktuar të bjerë edhe nëse nuk do të hiqen nga pushteti. Për Rohingiat nuk do të jetë fundi i përndjekjeve, por ngushëllimi se, në sajë të Papa Françeskut, nuk do të ndjehen më krejtësisht të vetëm e të braktisur.

*“Corriere della Sera”,
2 dhjetor 2017*

E shqipëroi: Eugen Merlika

Dom Nosh GJOLAJ
Podgoricë

PUSHIMI DHE UDHTIMI I PROGRAMUAR

(Pjesa e dytë)

2. Për një jetë sa më të gjatë dhe fatlume

Çifti martesor zakonisht pas martese është plotë entuziazëm, të fatlumë dhe me plot shpresë e besim. Por jeta e përditshme menjëherë ia rrëmben këtë freski, si bie fjala, mungesa e parasë (lekut), punësimi i të dyve, lindja e fëmijës, puna e zgjatur, pastrimi, blerja, larja, kuzhina, përgatitja e fëmijës për shkollë, për argëtim, ose për tenis, për vallëzim, mosmarrëveshjet e llojllojshme, brengosjet, pagjumësia, ankthi, frika, rragatja qofshin me fjalë qofshin me mendime të llojllojshme, sytë e uritur apo të etur për të pasuruar etj.

Jeta e përditshme jo vetëm se krijon frenime apo pengesat të llojllojshme por edhe sjellë pakënaqësi dhe depresion, ankth e mërzi. Një autor amerikan, i renditë njerëzit apo çiftin në disa kategori.

1. Në grupin e parë janë ata çiftet, të cilët askurrë nuk kujdesohen për pushimin e ditës, për pushimin javor, siç është pushimi i të dielës, e mos të flasim aspak nuk mendojnë për pushimin vjetor. Ata fare nuk kanë kohë për asnjë moment relaksimit jo vetëm fizik por as psikik. Gjithherë janë të dehur prej dëshirave për të pasur edhe më tepër. Tipi i tillë askurrë nuk është i kënaqur me jetën që e jeton, është i pangopur, i bezdisshëm, i pakënaqur dhe kalon thajse një jetë “qenit”. Po qe se i mungon puna, ai do ta krijojë, sepse përndryshe është i brengosur, i shqetësuar mos të themi i pafat. Shtëpia e tyre gjithherë është vetëm një ndërtimtari e përhershëm, si fjala vjen, prej punës profesionale shkojnë në kopsht, në pastrimin e shtëpisë, rregullimin e mobileve, pastrimin e dritareve etj... Menjë fjalë ai kurrë nuk ka kohë as për vete, as për bashkëshorten apo bashkëshortin, as për fëmijë, por është i tjetërsuar nga puna e tepruar. Ai jeton nga mendësia e gabuar, sa më shumë që të kesh aq më tepër vlen në syrin e tjetrit!

2. Në rendin e dytë i takojmë ata çiftet, të cilët janë gjithherë në rivalitetin e përhershëm qoftë mes vetes, qoftë me mjedisin në të cilin jetojnë qoftë me tjetrin - fqinjën e një profesionit. Ata dëshirojnë ta posedojnë televizorin me ngjyra, tipit të ri “Sony”,

internetin, telefonin e mençur tipit të fundi, të cilin nuk e kanë të tjerët, një automobil firmës së njohur, sepse atij nuk i pëlqen ta ketë veturën si shoku i punës, por diçka më të mirë dhe më modeste. Kuzhina duhet të jetë ndryshe e rregulluar, e stolitur që mos t'i përngajnë kuzhinave standarde, siç e kanë shumica e njerëzve të thjeshtë, sepse ne jemi një klasë më të lartë e më të aftë. Fëmijët e tyre duhet të jenë sportist më te mire të klasës, nxënësit shembullor, që ia kalojnë tjerëve. Mos të flasim kopshti i tyre duhet të dallohet nga kopshti i tjerëve, se këta janë më të ngritur dhe e kanë kopshtin më të mirë, më të bukur dhe më të rregulluar, që dallohet larg nga mjedisi në të cilin jeton. Fjala është për ata çiftet, të cilët vuajnë shumë



nga brendia e tyre, ashtu dëshirojnë për t'u treguar se janë dikush dhe janë diçka. Ashtu tentojnë të jenë në vëmendje për te qenë të parët, me qenë përpara të tjerëve ose mbi të tjerët, e askujt e askurrë të nënshtroar. Jetojnë gjithherë në ankth, në frikë, në presion: a do të jenë të aftë për t'u kacafytur apo ballafaquar gjithherë me dinamiken e ditës, sepse propaganda

konsumuese gjithherë sjellë novitetet e reja. E tipi i tillë nuk është i aftë për ta jetuar begatin e brendshme e për ta begatuar njëri-tjetrin me dashuri e fisnikëri por kanë mbetur skllevërit e rivalitetit të përditshëm. Siç thotë një anekdotë: Një njeri e kishte ndërtuar në shtëpi pranë rrugës kundrejt fqinjës, i cili e kishte një shtëpi të vjetër dhe gjithherë para saj duke pirë birrë e kalonte kohen. Fqinji sapo e vërejti se ardhacaku i ri e ka ndërtuar shtëpinë më të bukur dhe më të madhe se ai, i cili është me vitet tëra në këtë mjedis. Nga inati ngrihet dhe çon shtëpinë një kat më shumë se sa ardhacaku. Ardhacaku posa e vëren se fqinji i tij, përtacë e pijanecë e ndërtoi shtëpinë më të madhe se ai. Menjëherë i përvilet punës dhe e ndërton shtëpinë edhe një kat më shumë se sa fqinji i tij pijanec. Po sa e vëren pijaneci se ia ka kaluar ardhacaku, menjëherë edhe ky përvilet punës dhe e ndërton shtëpinë edhe një kat më të madh, e ashtu me radhë vazhdojnë deri në retë e qielli, dhe shtëpitë e tyre rrëzohen dhe mbetet një gërmadhë e madhe. Kjo paraqet mendësinë e rivalitetit!

3. Në grupin e tretë, do t'i takojmë çiftët të cilët jeton me orë në dorë, si të donin të bëjnë gara me jetën e përditshme. Çdo ditë ata e kanë të programuar dhe të përcaktuar se çka duhet të bëhet gjatë ditës, gjatë javës, gjatë muajit e gjatë vitit për ta realizuar, pikërisht ata janë skllëvërit e orarit. Ata vetëm vrapojnë për ta realizuar programin, bile në përpikëri, e nuk kanë kohë as të marrin frymë, e nuk u bie fare në mend pushimi as ditor, as ai javor edhe më pak ai vjetor. Ata zakonisht i kapin ethet mos të vonohen në punë, në zyre, në kancelari, në takim, në autobus, në aeroplan etj. Thuajse është i dehur nga orari i programuar, i cili nuk është i aftë për një program dhe plan të ri dhe real dhe të arsyeshëm. Menjë fjalë jeta e tyre është krejtësisht e programuar bile jo vetëm një javës por edhe vjetore. Janë të tjetërsuar dhe si të tillë janë mjaft nervoz, flenë keq dhe dridhen nga ethet e vonimit.

4. Në grupin e katër i takojmë ata çifte, të cilët janë të dehur nga mendësia materialiste dhe hedoniste (kënaqësive të epshit), siç fjala vjen, i fascinon paraja për të pasur sa më shumë, veshmbathja, shtëpia, automobili, mobilet shtëpiake, fotografat apo mobile të artit, parfum. Bashkëshortet e tillë flasin apo bisedojnë mes vetes, vetëm për çështje materialiste. Po qe se dalin së bashku rrugëve të qytetit, ata janë si të tretur apo të mpire nga reklamat e vitrinave apo të shitoreve, atyre nuk u intereson personi, individi as njëri-tjetri, por gjërat që i shohin në shitje. Po qe se e programojnë pushimin vjetor, do ta programojnë vetëm atëherë kur do të kenë kohë të mjaftueshëm, që zakonisht kjo kohë nuk gjendet. Po ashtu nëse shkojnë në pushimin vjetor, ata nuk shkojnë së bashku por shpërndahen sipas qejfit, si për shembull, njëri shkon në bjeshkë e tjetri në det, njëri merret me sport e tjetri rrezitet, njëri noton e tjetri viziton muzetë. Ata nuk kanë kohë askurrë njëri për tjetrin, as gjatë jetës së përditshme, as gjatë pushimit, as gjatë takimeve, as gjatë punës etj. Tipi i tillë është krejtësisht i tjetërsuar në mendësinë materialiste, hedoniste dhe subjektiviste.

5. Në grupin e pestë apo të fundit do t'i takojmë çiftet jo tolerant, si për shembull: njëri prej partnerëve nuk e duron trafikun e dendur, tjetri është me vullnetin e dobët, i mërzitur, sepse bashkë partneri e ka zgjuar para kohës. Një prej partnerëve nuk i duron fëmijët, të cilët lozin pjesën e poshtme të banesës, u pengon ecja e banorëve në katin e sipërm, askurrë nuk janë të kënaqur me programin televiziv, u shkon në nerva muzika me zë të lartë. Një familje e tillë kurrë nuk është në rregull, por gjithmonë në murmurime. Tipi i tillë është i bezdisshëm, i mërzitshëm, i pavullnetshëm dhe jo vetëm se vetes ia çel varrin por

edhe tjetrin e sjellë në të. Ata janë krejtësisht të tjetërsuar, që nga brendia e tyre buron frustrimi, mosrealizimi i ëndrrës së jetës, mos realizimi i dëshirave etj.

Po qe se çifti martesor i ka parasysh të gjitha këto faktet, nga këto pesë kategori që i numëruam më lartë, ai duhet të shkundet nga këto tjetërsime dhe të vendosin, po qe se dëshiron për të qenë i suksesshëm, atëherë është e domosdoshme programimi i përbashkët jo vetëm i jetës por edhe pushimin vjetor. Si parakusht është e domosdoshme zhveshjen nga ngarkesat e tepruara të çdo tipit që i numëruam më lartë, për ta krijuar jetën më të mirë dhe më të bukur. Njeriu si person duhet gjithëherë dhe kurdoherë me qenë në vëmendje dhe jo gjërat për rreth tij. Po ashtu edhe dashuria është ajo që sjellë jetën fatlume, po qe se ajo kuptohet drejtë dhe nuk lejohet që të materializohet apo bëhet objekt. Vetë fakti që njeriu tjetërsohet apo edhe materializohet e mos të themi behet objekt, ai jo vetëm se mbet skllav i vetvetes, pa liri dhe pa ardhmëri, por i rrëshqet nga dora edhe fati i jetës, e me të edhe dashuria! Si i tillë mbet jo vetëm i zbrazët por edhe pa perspektiv dhe jeta e tij është pa përmbajtje!

3. Si të arrihet deri te programi i përbashkët?

Nuk është lehtë t'i jepen dikujt recetat për të programuar jetën e përbashkët, dhe më e vështirë është programin e përbashkët për ta realizuar. Çifti e ka shumë të vështirë për t'i harmonizuar dëshirat apo kërkesat njërit apo të tjetri. Në anën tjetër dashuria është mjaft dinamike, fleksibile, e cila edhe ndërrohet, edhe di të korrigjohet, posaçërisht kur ndërlidhet me situatën konkrete, që e sjellë jeta e përditshme. Për një sukses është e nevojshëm jo vetëm durim, por edhe imagjinatë për ta shfrytëzuar ëndrrat e llojllojshme. Për shembull, njërit i shkohet në pushim gjatë verës, pikërisht në detin e kaltër të Adriatikut, përderisa tjetrit i shkohet në pushim dimëror dhe pikërisht në bjeshkë me borë për të bërë ski në alpe shqiptare. Tani si t'i harmonizojmë këto dy dëshira të skajshme?

Për t'i përpunuar programin e përbashkët nuk mjafton për jetën e përbashkët, që njëri prej partnerëve vetëm të mendojë në një program e tjetri të mbesin pasiv. Sepse shumica e çifteve, edhe nga ata që janë mjaft serioz gabojnë te programimi i përbashkët, sepse çdo njëri e bënë apo e harton programin e vet, dhe ai nuk mendon në nevojat apo dëshirat e tjetrit ose mundësit. Çdo gjë do të ishte e mrekullueshme, po qe se bashkë partneri është i tillë siç e paramendon ai tjetri, por ai nuk është i tillë, por ai është i ndryshëm, ai as nuk përputhet me pamjet tona, për këtë edhe rrëzohen si qyteti nga kartuçi të gjitha shpresat e të gjitha ëndrrat që i kemi paramenduar e hartuar për t'i realizuar së bashku. Gjithçka do të ishte në rregull, po

qe se ai ose ajo të ishte siç është “princi ose princesha në kalin e bardhë!” por është njeri i thjeshtë, i ligsh, i luhatshëm, i paparaparë, i ndërrueshëm, i dobët dhe dëshirat e tij apo nevojat nuk përputhen me ëndrrat tona.

Te hartimi i programimit të përbashkët, duhet të dallohet mirë vlerat e rëndësishme nga ato jo aq të rëndësishme, vlerat konkret dhe të nevojshme nga ato jo reale dhe të panevojshme. Shumica e çifteve nuk di të dallojnë në mes këshillimit, qëndrimit, vlerësimit dhe konkretizimit i këtyre vlerave. Ashtu edhe nxiten konfliktet në mes të partnerëve. Sepse një determinizëm i tillë paraqet në mënyrë konkrete njëanshmërinë subjektive të partnerit, që nuk kanë çka të bëjnë më me ideja e përbashkëta, por prapaskena është diçka tjetër. Në lojë nuk është sinqeriteti, as politika konkrete dhe hapja ndaj saj, por është ajo mënyra egoiste apo subjektive për ta aktualizuar politiken konkrete, nuk është në pyetje as puna, as profesioni por mënyra se si aplikohet veprimi në jetën e përditshme, siç bie fjala pushimi vjetor, që ia imponon çifti martesor partnerit tjetër.

Për ta punuar së bashku planin, është e nevojshme edhe shkalla e pjekurisë. Si fjala vjen, “Super mashkulli”, i cili mund gjithçka të vendosin, është i pavarur, i aftë për një jetë të pavarur nga tjetri, po ashtu në anën tjetër e kemi edhe “Super femra”, e cila është e zgjuar, inteligjente, femër e fort, e bindur, se ajo mund ta realizojë profesionin e vet pa ndihmën e tjetrit, dhe i sheh në raporte me mashkullin vetëm rrezik, që mund ta humbin dinjitetin e femrës etj. Çifti i tillë zakonisht nuk është i aftë për ta krijuar apo hartuar një program të përbashkët, edhe më pakë atë të vendosin së bashku kohën e pushimit si për shembull, pushimet verorë apo dimërorë!

Për një hartim të një programi të përbashkët, është e nevojshme apo e domosdoshme shkundja prej mitit të gjitha llojeve. Për shembull, çifti i ri nuk mendon se do të plakët një ditë, por mendojnë se do të mbeten vetëm djali i ri e vajze e re, të cilët jetojnë në botën e ëndrrave. Jetën e përbashkët e paramendojnë si një farë “parajse” në tokë apo në ndonjë ishull të një parajse. Mendojnë vetëm në marrëdhëniet seksuale sipas tyre nuk duhet të kenë kufij, sepse ato i’a japin domethënien e dashurisë dhe jetës së përbashkët dhe të përhershme, vetëm për vete të mbesin gjithherë të dashuruar. Fakti, vetë familja është nga natyra gjithherë në gjendje konfliktit, sepse dashuria e

vërtetë gjithherë e kurdoherë kërkon, jo vetëm orvatje por edhe flijim, ashtu ka edhe momentet e monotonisë, ngopja seksuale, rutina e ditës... Po qe se çifti i ri apo të dashuruarit ëndërrojnë të ardhmen në këtë mënyrë, në një shtëpi të kënaqësive, duke mos menduar fare a është e mundur një jetë e tillë për ta realizuar. Fatkeqësisht kemi edhe të tillë, si mos ta kishin kokat e veta për të menduar, sepse lindja e fëmijës apo sëmundja e tij jo vetëm se ia rrënon qytetin e ëndrrave apo parajsën, por ia ndërron krejtësisht programin e jetës.

Te një programim i mirë dhe real, është e nevojshme të verifikohen të gjitha vlerat dhe të gjitha mundësit. Që do të thonë, se partnerët janë të aftë për t’u përcaktuar për qëllimin kryesor. Kuptohet sa duhet



kohë për ta realizuar programin, mënyra si duhet ta harmonizohet, ashtu lehen mundësit e korrigjimit gjatë rrugës së përbashkët ndaj qëllimit të fundit etj.

Mund të themi, se një projekt i mirë, e mirë i definuar, që i ka pikat e përbashkëta e njëherë i ndërlihd pikëpamjet e skajshme si të njërit ashtu edhe të tjetrit, një projekt i tillë me siguri do të stabilizojnë atmosferën e brendshme, si njërit ashtu tjetrit. Sepse nuk do të vuajnë se unë humba e tjetrit fitoi, por menjë fjalë krijohet edhe baraspesha në mesin e partnerëve. Siç është shtëpia në harmoni në mes ndërtesave dhe të mjedisit, në mes madhësisë dhe volumit, në mes materialit e ngjyrës, në mes funksionit dhe bukurisë, ashtu është edhe programi i harmonizuar në mes bashkësisë dhe nevojave të individit, në mes dashurisë dhe të faljes, në mes të jesh i dashuruar dhe kërcënimit, në mes vendimit e dëshpërimit, në mes idealit dhe mundësisë, në mes orvatjes e humbjes, në mes lirisë dhe detyrimeve, në mes arsyes së mendjes dhe të emocioneve.

Po qe se i respektojmë këshillat e tilla edhe pushimi vjetor do të jetë ajo gurra e freskimit jo vetëm shpirtëror por edhe frymëzues e krijues.

Dom Ernesto KOCI

STUDIME ETNOLOGJIKE TË SHQIPËRISË S' EPËRME

Botues: Gjergj Fishta, Lezhë, 2017.

Vepra, që po paraqesim është një përmbledhje në gjuhën shqipe të studimeve dhe gjurmimeve në lëmin e etnologjisë shqiptare të Imzot Ernesto Cozzi-t, njëri nga albanologët e shquar, por që për shumë arsye, jo aq sa duhet i njohur, një emër që çuditërisht, ashtu siç shkruan K. Ulqini: “.....tepër rrallë gjendet në bibliografitë kryesore apo në citime të zakonshme.

Ernesto Cozzi, ashtu si shumica e albanologëve, ishte i huaj italo-austriak nga Trentoja. Ai u lind më 6 korrik 1870 dhe vdiq 23 mars 1926. E deshi Shqipërinë aq fort, sa që trupi do gjente prehje vetëm këtu. Ndonëse vdiq dhe u varros në Bari, u zhvarros dhe u rivarros në Shkodër, më 29 maj 1926, i nderuar, jo vetëm nga populli, por edhe nga përfaqësues të shtetit dhe të trupit diplomatik.

Vështirë të përmbledhësh në pak rreshta veprimtarinë e gjithanshme të këtij personaliteti nga radhët e klerikëve italianë që shërbyen në Shqipëri. Një jetë e mbushur me veprimtari mes shërbesës fetare, studiuesit të censhëm të kulturës shpirtërore dhe materiale të shqiptarëve, mbrojtësit të të drejtave kombëtare të tyre, hierarkut të lartë të kishës katolike në Shqipëri, por dhe diplomatit, pasi, në vitin 1921, ai ishte Delegati i parë Apostolik i Vatikanit, shteti i parë, që e njohu shtetin e ri shqiptar, të dalë nga Kongresi i Lushnjës (21-31 janar 1920).

Tokën shqiptare i frymëzuar nga misionarët italianë me dëshirën e tij, e shkeli në vitin 1901. Braktisi jetën e qetë të udhëheqësit shpirtëror në Ala, Levico, por edhe atë të famullitarit në Bolzano, për të vijuar më tej shërbesat në Malësi të Madhe, Dukagjin e Postribë, Zadrimë, Mirditë e Shkodër.

Ndonëse erdhi në kohë të krizave politike dhe fetare pasojë e pushtimit të gjatë turk, por edhe të ngjarjeve politike të gjysmës së dytë të shekullit XIX që përfshinë Ballkanin, mjeti më i vlefshëm i jetës së tij misionare ishte lidhja me banorët, me qëllim kryesor riungjillizimin e tyre, por edhe dëshmimin para botës së qytetëruar të një kulture autoktone të pacenuar, nga civilizimi, të banorëve të trevave malore, Siç shkruante P. Engjell Serreqi, ai punoi “ *me zell të palodhur për shpëtimin e shpirtërave, prandaj ishte i dashur dhe i nderuar prej të gjithëve*”

E. Cozzi nuk ishte indiferent edhe përkundrejt ngjarjeve, që lidheshin me proceset politike dhe vijimësinë e popujve nën Perandorinë Turke. Në



Dom ERNESTO COZZI

STUDIME ETNOLOGJIKE
TË SHQIPËRISË
S'EPËRME

festimet në favor të Kushtetutës turke të vitit 1908 të bëra në Shkodër, Edit Durhami, e pranishme në festë, kujtonte edhe priftin e Reçit, Ernesto Cozzi-n, ushtarak, mbi një kalë të bardhë dhe me zagarin, që e ndiqte prapa, i cili sapo u lexua dekreti i shpalljes së “Hyrjetit” kërceu mbi platformë dhe me zërin e tij tingëllues, (me një shqipe të mirë- shën i yni) mbajti një fjalim të çastit që e mbylli me thirrjet: “Rroftë kushtetuta”, Rroftë Padishahu” Rroftë shqiptaria”.

I vëmendshëm kundrejt çdo gjëje që e rrethonte, hapësira e shërbesës zgjerohej. Krahas përhapjes së dritës së besimit fetar, me kërshërinë e një studiuesi, iu fut edhe hulumtimeve të kulturës materiale dhe shpirtërore të fiseve malësore, që do ta bënë atë një ndër personalitet më të shquara të fushës. Të strukur në lartësitë e mëdha të bjeshkëve, në një ndërthurje të çuditshme të maleve dhe luginave malësorët mes skamjes mjerane të jetës arritën të ruajnë pak a shumë të paprekura thesaret etnike, që mund të përcaktohen, si: “....pasuri zanafillore të racës, në gjuhë dhe në tradita”

Hulumtimet në fushën e etnologjisë të filluara që herët në shekullin e XVII (kujto Frang Bardhin (1606-1643) , që mes të tjerave hulumtoi edhe me folklorin dhe etnografinë e Zadrimës- shën. ynë) njohën kulme përgjatë shekullit XIX dhe gjysmës së parë shekullit XX. Klerikë të urdhrave të ndryshëm fetarë, por edhe mjaft studiues kryesisht të huaj, e ndonjë shqiptarë ndodheshin në terren, duke pasqyruar rezultatet e punës përmes mjaft veprave, por edhe relacioneve drejtuar selive të ndryshme qeveritare dhe qendrave shkencore të kohës.

Edhe E. Cozzi, ishte njëri nga ata, ”studiues të zellshme të zakoneve shqiptare por puna e tij pati të veçantën e vet. Ai nuk ishte i financuar, apo edhe i mbështetur nga ndonjë instancë shtetërore apo organizëm shkencor, pasi hulumtimin e shikonte si pjesë e misionit të një kleriku. Në mungesë të plotë të dokumentacionit të shkruar, ai ndoqi rrugën e mundshme të udhëtimeve duke kërkuar së pari dëshmitë e njerëzve, por duke pasqyruar edhe çdo gjë të veçantë që vërente sa i takon dokeve, zakoneve, traditave, besëtytnive, elementëve psikologjikë dhe moralë të banorëve.

Me nuhatjen e një studiuesi të mirëfilltë, gjithnjë duke u bazuar vetëm në burime tregimtare ai arriti të klasifikojë materialin e grumbulluar për një periudhë pesëvjeçare (1909-1914) dhe të na japë shtatë vepra. Të sigurte në aftësitë e autorit, por edhe në seriozitetin shkencor të trajtesave, veprat u botuan në revistat shkencore të fushës: “Anthropos”, “Revue d'ethnographie et de sociologie”, “Studi albanesi”, që publikoheshin në Vienë, Paris dhe Romë. Pjesë të veprave u botuan edhe në revistën “Përparimi” të Etërve jezuitë.

Më poshtë po radhisim kronologjikisht veprat e botuara:

“Sëmundje, vdekje, varrime, Malet e Shqipërisë” (1909)

“Gjendja bujqësore në Shqipëri” (1910)

“Marrja e gjakut në Malet e Shqipërisë” (1910)

“Gruaja shqiptare në një veshtrim të posaçëm nga e drejta dokësore e Maleve të Shkodrës” (1912)

“Fiset e Shqipërisë së Sipërme –shënime rreth organizimit të tyre shoqëror e politik” (1913)

“Besime dhe bestytini në Malet e Shqipërisë” (1914)

“ Fiset e Shqipërisë së Sipërme-shënime rreth organizimit të tyre shoqëror e politik me të dhëna statistikore” (1944).

Ndër tërë veprat e E. Cozzit vepra e fundit sa i takon lëndës që përmban, përmbledhje normash juridike popullore të regjistruara në Malësi të Shkodrës gjatë dhjetëvjeçarit të parë të shekullit të

XX, “...cilësohet si kryevepra e Cozzi-t. Në këtë lëmë ai i kaloi paraardhësit e vet (J.G. von Han, H. Hekard, N. Ashta, L. Mjeda e M. E. Durham).

E me gjithë vlerësimin, autori modestisht nuk ka pretenduar të ketë bërë një studim shkencor, pasi siç e pohonte, “.. për të tilla studime duhej një kulturë shumë e gjerë në shkencat juridike, që mua më mungon.

Studimet E. Cozzi-t ngelen si pjesë e artikujve të periodikut. Ato asnjëherë, sa qe gjallë autori, nuk u arrit të publikoheshin si një libër i veçantë.

Studimi “Fiset e Shqipërisë së Sipërme, që në dorëshkrim (1912) pati mbështetjen e konsullit austro-hungarez në Shkodër, Zambaur. Ai përmes kontit Bertold arriti të sigurojë mjetet financiare për botimin e saj, e cila fatkeqësisht nuk u arrit.

Bazuar në të dhënat e G. Valentini-t, të konfirmuara edhe nga Kahreman Ulqini, (njeri ndër etnologët e shquar shqiptarë) rezulton që vepra kishte filluar të shtypej në shtypshkronjën D.A. Kajon në Sarajevë. Vetë E. Cozzi kishte marrë për t'i korrigjuar bocat e para, por më tej: “.. se për ç'arsye vepra nuk përfundoi. E ngelur në dorëshkrim sipas të dhënave edhe të M.E.Durham, ajo u shkatërrua gjatë viteve të Luftës. Vetëm në vitin 1944, vepra u botua nën kujdesin e atë G. Valentinit, në Buletinin “Studime dhe tekste”, organ i Institutit të Studimeve Shqiptare duke e kodifikuar në tre libra: I. E drejta civile (familja , miqtë, prona). II. E drejta penale (kundrime paraprake , krime kundër njeriut, krime kundër pronës, ligje të posaçme vendore, procedurat). III. “Struktura politike (fisi, bajraku, në nëndarjet e bajrakut, qeverisja e fisit, e bajrakut dhe nëndarjet).

E. Cozzi – në gjykimin e K. Ulqinit- zë një vend nderi, (ndonëse të mohuar) në albanologji, i konsideruar, ”ndër njohësit më të mirë të terrenit shqiptar krahas F. Nopçës e M. E. Durham.

Atë G. Valentini S.J., njohës i drejtpërdrejtë i psikologjisë dhe të dokeve të Malësisë së Madhe, vlerësonte tek E. Cozzi, cilësitë e çmueshme dhe të domosdoshme që ai kishte si punonjës shkencor, aftësitë për të vërtetuar tezat e parashtruara, duke “...vjelur shumë burime , e për të veçuar gjatë parashtrimit atë që është subjektive prej asaj që është objektive ”

E gjithë kjo punë shkencore pas vitit 1944, u tret në zbrastësinë që krijoi heshtja dhe mohimi nga diktatura komuniste, aq më tepër që kishin të bënim me një emër të hierarkisë së lartë kishtarë. Emri i tij ishte i panjohur, vepra po ashtu. Të botuara në gjuhën italiane dhe në revista të huaja të fillimeve të shekullit XX, studimet e E. Cozzi-t me vështirësi

mund të gjendeshin në Shqipëri, dhe nëse gjendeshin duhej leje e posaçme për t'i konsultuar.

Por gjurmët ngelin, ata janë më të forta se harresa e qëllimshme. Ndërsa një palë studiues endeshin në zbulimin e të fshehtave të një populli, të tjerë studiues përpiqeshin që të sillnin në kohë, por edhe në gjuhën shqipe, veprat e atyre autorëve që siç thuhet shpesh “nuk mund të fshihen me një të rënë lapsi”.

Vepra e E. Cozzi-t do të vijonte të ishte e panjohur për publikun shqiptar, pa kujdesin dhe përpjekjen e W. Kamsit, (1926-2017) një ndër personalitet në zë të gjurmimit të letrave shqipe, por edhe të autorëve të huaj dhe shqiptarë që janë marrë me problemet albanologjike.

I ndjeri **Willy Kamsi**, lindi me 17 dhjetor 1926 dhe u rrit në Bari (Itali) në familjen e Gjon Kamsit, (1894-1992) njëri nga ekonomistët e shquar shqiptarë, me mjaft kontribute në mbarëvajtjen e institucioneve financiare të shtetit shqiptar në periudha të ndryshme. Ka qenë publicist i njohur, autor i mjaft trajtesave të karakterit ekonomik e finaciari, por edhe politik, historik, letrar dhe gjuhësor të botuara në shtypin e kohës, brenda dhe jashtë vendit. Ai ishte mik i shumë patriotëve mes të cilëve edhe i Luigj Gurakuqit. Për një periudhë 39 vjeçare ruajti rrobat e përgjakura të Luigj Gurakuqit, të vrarë në Bari në vitin 1925, për t'i dorëzuar në Shtëpinë muze kushtuar Heroit tonë Kombëtar Luigj Gurakuqit (kjo Shtëpi fatkeqësisht nuk ekziston më – shën. ynë). Gjon Kamsi ishte i pari që botoi veprën “Vjersha” të L. Gurakuqit, firmosur me pseudonimin Gjiam. Me këmbënguljen dhe guximin qytetar, përmes letrave dërguar organeve të larta shtetërore të diktaturës komuniste u arrit të shpëtoheshin Varrezat Katolike të Rrmajit të shpallura tanimë “Monument Kulture”.

Willy, ndoqi shkollimin fillor dhe të mesëm në Institutin “De Cagno Abbresci”, të Barit deri në qershor të vitit 1943, kur familja kthehet në Atdhe; në vitin 1948 merr maturën në Gjimnazin e Tiranës, ndërsa në vitin 1975, mbaron studimet e larta në degën histori-geografi.

Një vit pas rikthimit në Shqipëri, më 1944, ndonëse akoma pa mbushur të shtatëmbëdhjetat ai u angazhua në Bibliotekën e Institutit të Studimeve Shqiptare, drejtori së cilës Filip Fishta, që e ndihmoi atë të përvijonte formimin albanologjik, të cilin e vijoi deri në frymën e fundit të jetës.

Fryt i kësaj shtyese ishte krijimi dhe pasurimi i fondeve albano-balknologjike të bibliotekës I.L.Pedagogjik të Shkodrës (sot universiteti “L.Gurakuqi- shën ynë”) dhe “At Zef Valentin S.J.”,

pranë Seminarit Ndërdioqezan Shqiptar në Shkodër, por edhe veprimtaria e larmishme studimore.

Bibliografia personale e hartuar nga vetë W. Kamsi, e dëshmon më së miri veprimtarinë e gjërë kërkimore-shkencore. Ajo përmban një sërë njësisish të grupuara në: I. Artikuj dhe studime (146 njësi); II. Studime shkruar në italisht dhe anglisht, (22 njësi). III.Parathënie (9 njësi); IV. Fjalime dhe diskutime (11 njësi); V. Intervista (9 njësi); VI. Përkthime (23 njësi); VII. Recensione dhe promovime (16 njësi); VIII. Biblioteka e bibliografi (19 njësi).

Tërë prodhimtari e tij shkencore e shpërndarë në revista të ndryshme, kryesisht shkencore, të botuara në Tiranë dhe në Shkodër, si: *Studime gjuhësore* (Tiranë), *Monumentet* (Tiranë), *Buletini Shkencor* (Shkodër), *Kumtari i Muzeut*, *Phoenix*, *Shkodra ndër shekuj* (Shkodër), por edhe në organe të ndryshme periodike të klerik katolik etj., rrok në pjesën më të madhe probleme albanologjike, që lidhen me gjuhësinë, arkeologjinë, monumentet e kulturës, të drejtën zakonore, historinë, figurat e spikatura kombëtare etj., një pjesë e të cilave janë edhe në gjuhë të huaj.

W. Kamsi ishte pjesëmarrës në shumë konferenca dhe sesione shkencore brenda dhe jashtë vendit. Një vend të rëndësishëm zë edhe pjesa e krijimtarisë të lidhur me profesionin e tij, studimet në fushën e bibliotekave dhe kolanën bibliografike të revistave: “Albania” (1897-1909), “Hylli i Dritës” (1913-1944), “Leka” (1929-1944), “Shkëndija” (1940-1943).

I rritur në një mjedis familjar, por edhe shoqëror mjaft të kulturuar, W. Kamsi u lidh përjetësisht me librat dhe gjurmimin e teksteve të vjetra të shqipes, duke u bërë një zë autoritar në këtë fushë. Objekt i hulumtimeve të tija u bë edhe Arkivi dhe bibliotekat e Vatikanit, gjatë kohës që ai ishte në detyrën e Ambasadorit të parë të Shqipërisë në Shtetin e Vatikanit, (1992-1996) aq sa në këto ambiente ai filloi të njihej edhe, si “ambasadori hulumtues”.

Zotërues i disa gjuhëve të huaja, të vdekura (greqisht, latinisht) dhe perëndimore (italisht, frëngjisht, anglisht), ai arriti t'i japë lexuesit në gjuhën shqipe, veprat e mjaft autorëve të huaj, mes të cilëve veçojmë: G. Biemi, B. Pagnin, M. Rocques (“Gjurmime mbi tekstet e vjetra të Shqipes”, “Frang Bardhi dhe Fjalori i tij”), Atë Zef Valentinit, G. Brunelli etj.

W. Kamsi ka meritën e sjelljes në shqip nga italishtja të pjesës më të rëndësishme të veprave të E. Cozzi-t. Ndonëse kishte njohuri të sakta bibliografike, për vendodhjen e tyre iu desh të kapërcente praktikat burokratike të kohës, përdorimin literaturës siç quhej në atë



kohë“rezervat”, që gjendej në Bibliotekën Kombëtare, përmes filmimit të materialeve, të cilat si dëshmi gjenden në shtëpinë e tij ,së bashku edhe me faturat përkatëse.

Librat u përkthyen nga vitet '80 të shekullit të kaluar, por vetë përkthyesi i mbajti në sirtar, pasi ishin të destinuara, ashtu si edhe një pjesë e madhe e veprave të autorëve të klerik katolik, të ngeleshim si “prodhimtari e sirtarëve”.

W. Kamsi ishte i bindur, që veprat e E. Cozzi-t ndonëse u shkruan në fillimet e shekullit XX, ngeleshin gjithnjë aktuale për etnologët shqiptarë, dhe sidomos për studiuesit e të drejtës zakonore, që do të kishin në duar një variant tjetër të “Kanunit të Lekë Dukagjinit”.

“ E. Koci e Sh. Gjeçovi- shkruan K. Ulqini,- i përfunduan veprat e tyre rreth të drejtës popullore pothuaj në të njëjtën kohë, por, me sa kuptohet nuk bashkëpunuan njëri me tjetrin. Pavarësisht nga kjo normat kanunore të regjistruara në Malësi të Shkodrës nga E Koci dhe në Mirditë nga Gjeçovi janë dy variantet më të rëndësishme të Kanunit të Lekë Dukagjinit dhe njëkohësisht fondi kryesor i korpusit të së drejtës popullore shqiptare”

Për shumë arsye, W. Kamsi nuk arriti t'a shikojë të botuar përkthimin e hulumtimeve të E. Cozzi-t, por ai arriti të shqyrtojë deri në imtësi, sjelljen në shqip të tyre, duke korrigjuar disa herë dorëshkrimet, me skrupolozitetin shkencor që e shoqëronte.

Libri është shkruar në një gegnishte të pastër,

tradicionale. Ai ruan të gjithë elementët morfologjike dhe sintaksorë të shqipes, kështu, ai ka një vlerë të shtuar.

Vdiq papritmas në moshën 91 vjeçare, më 27 janar 2017, duke lënë pas vetes një program të vërtetë pune për të realizuar. Ndonëse kishte moshën, përsëri ashtu si për një pjesë e mirë e intelektualëve të shquar, moshë ngelet gjithnjë një konvencion, pasi të tillë njerëz, lënë një boshllëk kulturor që duhen vite për t'u plotësuar.

Më botimin e këtij libri kemi filluar plotësimin e një pjesë të planit të botimeve të lëna të gatshme nga W. Kamsi, i cili përmban, korpusin e punimeve shkencore vetjake në shqip dhe në gjuhë të huaj, botimin e ditarit dhe të studimeve ekonomike të të atit, Gjon Kamsi, “Ditarët e Shuk Gurakuqit”, “ Holandezët në Shqipëri” të Gorrit T. A. Goslinga, vijimin e bibliografive, përkthime etj.

Të bindur se studimet e E. Cozzi-t do të mirëpritën, menduam që botimi i këtyre përkthimeve është homazhi më i mirë që mund t'i dedikohet W. Kamsit, një ndër bibliotekarët dhe bibliografët më të shquar shqiptarë, studiuesit të censhëm jo vetëm të qytetit tonë, por edhe më gjerë.

***Marrë nga Shqiptarja.com,
dt. 17 dhjetor 2017.
Dom Nikë Ukgjini
Gjovalin Çuni***

Gjovalin SHKURTAJ
Tiranë

“SHQYPTARIJA”, LIRIA DHE GJUHA SHQIPE NË JETËN DHE SHKRIMTARINË E DOM NDRE MJEDËS

Ditët e Mjedës, Kukël, 18 nëntor 2017

Më 18 nëntor, në fshatin Kukël të Zadrimës, pikërisht në mjediset ngrehinës që ka qenë shtëpia e Mjedës, tashmë e kthyer në Qendrën Muzeore “Dom Ndre Mjeda” u bë një veprimtari e bukur shkencore e kulturore artistike, e cila kishte si temë bosht 100-vjetorin e botimit të vëllimit poetik “Juvenilia”. Në vitin 1917, në Vjenë të Austrisë, poeti botoi librin e tij të parë dhe të fundit të jetës, të quajtur me një titull latin, vezullues dhe të përjetshëm “Juvenilia”. Ky libër është padyshim një nga librat më të rëndësishëm të poezisë shqipe në 5 shekuj të ekzistencës së saj të shkruar, që nga Gjon Buzuku e deri më sot. Kjo ditë, e cila ka hyrë tashmë në listën e veprimtarive të përvitshme, që bëhen në atë mjedis, sivjet përkonte edhe me ditëlindjen e poetit tonë kombëtar Dom Ndre Mjeda (20 nëntori 1866), prandaj drejtuesi i qendrës, dr. Dom Nikë Ukgjini, në bashkëpunim e me mbështetjen e ministres së Kulturës Mirela Kumbaro, bëri edhe përrurimin e ribotimit të veprës “Juvenilia”, botim anastatik nga Botime “Gj.Fishta”, Lezhë. Ishte një veprimtari e bukur, sa e thjeshtë, aq edhe me përmbajtje e vlera të shënueshme shkencore, kulturore dhe artistike, me pjesëmarrje të një numri të mirë personalitetesh zyrtare e studiuesish të njohur, midis të cilëve edhe zëvendëskryeministrja, Senida Mesi, ministrja e Kulturës, prof. Mirela Kumbaro, konsulli nderit të Austrisë Gjergj Leqejza, akademikë nga Tirana dhe profesorë e studiues nga Universiteti i Shkodrës “L.Gurakuqi”, si dhe dashamirë të Dom Ndreut. Ndër ta, edhe skulptori i njohur, prof. Sadik Spahiu, realizues i shtatoret madhështore të Dom Ndre Mjedës, që është vendosur në oborrin e Qendrës Muzeore kushtuar poetit të shquar kombëtar, priftit dhe veprimtarit shoqëror e atdhetarit të flaktë Dom Ndre Mjedës. Veprimtaria ishte nyjtuar si një “meshë” artistike dhe kulturore shkencore, një gjë sa e re, aq edhe origjinale, përderisa salla ku u organizua, ka qenë kisha e famullitare e Kuklit, ku Mjeda jetoi e meshoi për shumë vjet.

Na uroi mirëseardhjen drejtori i qendrës muzeore Dom Nikë Ukgjini, pastaj, në shoqërimin

e këndshëm të një tresheje orkestrale dhe interpretime të poezive të Mjedës nga një grup nxënësesh të gjimnazit “Jordan Misja” të veshura me kostumin tradicional të Zadrimës. E merrnin fjalën të ftuarit, duke sjellë secili mesazhe të formuluar shkurt që synonin vlerësimin e jetësimit e asaj pune madhështore, që është bërë në atë fshat të vogël për Mjedën e Madh. Përpos pohimeve me karakter zyrtar e sidokudo edhe solemn, nga përfaqësuesit e shtetit e Bashkisë të Vaut të Dejës, u mbajtën edhe kumtesa shkencore rreth veprës “Juvenilia” dhe krejt shkrimtarisë e veprimtarisë së Ndre Mjedës, nga studiues, shkrimtarë, poetë dhe arsimtarë të pranishëm. Përmendim referimet e prof. dr.Tomor Osmani “Mjeshtër i Madh”, i cili vlerësoi ndihmesat e Mjedës si anëtar i Komisionit Letrar të Shkodrës dhe si gjuhëtar i dalluar; prof.dr Alfred Çapaliku, i cili u ndal në vlerat artistike të poezive të Mjedës në përgjithësi e të “Juvenilies” në mënyrë të veçantë. Kumtuan edhe studiues nga Kosova, Zija Vukaj dhe prof.dr.Agim Vinca, kumtesën e të cilit kushtuar artit të Mjedës si poet i veçantë e lexoi Erlinda Ramadani.

Me këtë rast, në vargun e kumtuesve, unë lexova një pjesë të kumtesës sime me titullin “Shqyptarija” dhe përbashkësia e gjuhës si dëshmi e njësisë së kombit shqiptar në veprat e Ndre Mjedës. Rasti e donte që, të ritheksoja disa vlerësime, që i kam shprehur edhe më parë në disa shkrime për Mjedën, duke përforcuar mendimin se Ndre Mjeda, qoftë në vjersha e poema, qoftë edhe në krejt veprimtarinë e tij shkencore, atdhetare, politike, arsimore etj. mbetet një nga prijësit dhe luftëtarët më të zjarhtë që përbashkësia e gjuhës të ishte mjeti kryesor i njësimi e përparimit të kombit shqipt. Tehun e asaj që mund të themi e kemi nyjtuar në këto tri fjalë çelës: *Shqyptarija, lirija dhe gjuha shqipe*. Ato ishin, janë dhe mbeten leksemat jo vetëm më të shpeshta, por edhe më të dashurat, më atdhetaripohueset në veprimtarinë e shkrimtarinë e Ndre Mjedës. Vjershëria e Ndre Mjedës ka “vulë” të dukshme e të theksuar atdhetarie, duke dalë, ashtu si bashkëkohësi e

bashkëvendasi tjetër
zadrimor, Atë Fishta,
ideator dhe mëtues i
pamposhtur i pohimit:

*Kjoftë mallkue,
kush qet
ngatrrime,/Nder kta
vllazën shoq me
shoq/kush e dan me
fjalë e shkrime,/ Ça
natyra vetë përpoq!*

“Shqyptarija”, të cilën Mjeda e shkruan gjithmonë me shkronjë të madhe, te Mjeda, kjo fjalë është zgjedhur si figurë e gjallë, e shenjtëruar, e shpirtëzuar, sikundër shihet, mbi të gjitha, te soneti “Andërr”, personifikimi me vlerë madhore dhe absolute kombëtare, simbol i devotshmërisë, i përkushtimit dhe virtyteve që përbëjnë identitetin shpirtëror të njeriut, të atij që i thotë vetes shqiptar. “Shqyptarija” ka qenë te Mjeda motërzim i vetë qenies së tij, prandaj, edhe kur botoi “Andërr”, sikundër e ka përmendur edhe studiuesi Sabri Hamiti, ai nënshkroi me pseudonimin “Shqyptari”. Vetë lokja, nëna a tij, e kishte ushqyer që në moshë të njomë duke i thënë: “Nji nanë tjetër, thoshte ke,/ Bir, n'ket dhe,/ Nana jote asht Shqyptarija”. Vjershat dhe poemat e Ndre Mjedës janë kushtim për ruajtjen dhe mbrojtjen e tërësisë trullësore të kombit e popullit shqiptar, duke u shprehur qartë e katërcipërisht edhe nëpërmjet toponimisë që përmend e shtie në vargjet e veta, si p.sh.:

*“Prej Tivarit e n'Prevezë,/ Nji â giuha e kombi
nji,/ Ku lëshon dielli njato rreze/ Qi veç toka jote i
di”.*

Askush më bukur, po edhe aq me forcë e ndikim në thelb të zemrës së popullit, nuk i ka kënduar njësisë dhe përbashkësisë së dy dialekteve të shqipes, sa Ndre Mjeda, kur thotë: “Geg'e Toskë, Malci, jallija,/ Jan nji komb, m'u da s'duron/ Fund e maje nji â Shqypnija,/ E nji gjithë t'gjith' na bashkon”.

Kësaj ideje madhore (të njësisë dhe përbashkësisë së shqiptarëve, të lidhur me një gjuhë “shejte” e të vetme) Mjeda i është qasur e rikthyer disa herë e gjithmonë me theksim e ton kushtimues, si p.sh. te vjersha “Bashkonju“, ku ai



thërret: “Mblihn'ju vllazen, e bashkon'ju/ Nen flamur të Shqyptaris:/ Prej nji gjaku, nji gjinis/

*Â shqyptari kand e kand./ Nji giuhe shejte
t'gjith kuvësim/ Nji istori, nji atdhe ne kemi,/ Geg' e
Toskë nji zemre jemi/ Me ndjekë Shqype hovin
tand.”*

Mjeda ishte teolog, shkrimtar, gjuhëtar, deputet, themelues i shoqërisë kulturore “Agimi”, hartues i alfabetit shqip. Ka qenë një punë shumë e vlefshme e me rëndësi të madhe kombëtare krijimi i Qendrës Muzeore “Dom Ndre Mjeda”, pikërisht në shtëpinë e kishën ku ka vepruar poeti ynë i madh dhe për hir të punës së madhe të Dom Nik Ukgjinit, së bashku me institucionet e larta të shtetit, me donatorë e dashamirës të kulturës janë përvijuar realizuar projektet e njëpasnjëshme pranë kësaj qendre dhe sot është krenari, që kjo qendër kulturore funksionon dhe tërheq njerëz elitare nga Shqipëria e më gjerë. Këtë qendër e kanë vizituar dhe kane marrë pjesë në aktivitete të përvitshme që nga viti 2012 një numër i konsiderueshëm përfaqësuesish të trupit diplomatik në Shqipëri, udhëheqës e politikanë nga Shqipëria dhe nga Kosova, akademikë, studiues, shkrimtarë, poetë, pedagogë, mësues, studentë, nxënës shkollash etj.

Ja pse, edhe në veprimtarinë e djeshme, mora pjesë më kënaqësi dhe, në paça jetë e shëndet, përsëri do të marr pjesë e do të kumtoj për vlerat e pavdira të poetit, gjuhëtarit, atdhetarit dhe njeriut të shquar, Dom Ndre Mjeda.

Marrë nga: Gazeta Shqiptare, 20.11. 2017

BREZI I RI NA NEVOJITËT MISIONARË IDEALISTË, SHËRBESTARË TË DIJES DHE KULTURËS

*"Ditet e Mjedës", 18 nëntor 2017, në Kukël, Shkodër.
Fjala e Ministres së Kulturës, znj. Mirela Kumbaro në edicionin e 13-të*

"Një javë më parë kujtuam lirikun modern të gjuhës shqipe, Lasgush Poradecin, që i këndoi ëmbëlsisht vendit, natyrës dhe shpirtit të lirë. Po shtegëtimi i shtërgut të tij kishte nisur shumë përpara, ndoshta nga kanga e bylbylave të Ndre Mjedës, lirikut klasik të letrave shqipe. Ky gjurmim për rizbulimin e autorëve tanë, rikthimin ndryshe dhe rivlerësimin është sot më tepër se kurrë i domosdoshëm. Rileximi është një akt personal, është reflektim dhe ri interpretim në kohë. Dhe Ndre Mjeda, mendimtari dhe ëndërrimtari, që mundi të tejkalojë dhe vetveten dhe shtërngesën e rregullave të rrepra të formimit, është shtegëtar i par excellence, i cili na mbërrin i freskët dhe me shumë kumte për të na komunikuar. Mbi të gjitha, na komunikon atë më thembësoren dhe më njerëzoren, dashurinë për jetën. Dhe këtë dashuri e përcjell me finesë prej fisniku, pasuri prej gjuhëtari, dhembshuri prej murgu, mençuri prej filozofi dhe elegancë prej poeti. Do t'i kishte mjaftuar veç "Andrra e jetës" për ta përligjur si poet me një estetikë të përsosur dhe veçanti të papërsëritshme. Në përpjekjen tonë për të afruar brezin e ri me librin, për të rizgjuar dhe rizbuluar kënaqësinë e të lexuarit, na ndihmojnë pikërisht poetë si Mjeda, ku domosdoshmëria e mesazhit dhe thellësia e mendimit rrëshqet ëmbël përmes estetikës së fjalës.

Në dëshirën për nxitjen e leximit dhe kthimin e vëmendjes te libri tek brezi i ri na nevojitet misionarë idealistë, shërbestarë të dijes dhe kulturës, që mund të bëhen shembuj frymëzimi: sepse ndryshimi fillon nga motivimi, fillon nga dëshira, fillon nga shpirti për t'u përpunuar më pas në mendje e për t'u kthyer në program.

Këtë gjë e ka ditur dhe e ka praktikuar shumë herët Mjeda, që në ushtrimin e detyrës si famullitar edukator, që giatë përpjekjes për t'u mësuar fëmijëve gjuhën shqipe përmes hartimit të një vargu librash

ku dija përcillej përmes bukurisë dhe elegancës së poezisë. Kemi nevojë për figura të tilla modele të përkushtimit që arrijnë të përçojnë mesazhe të rëndësishme, që ia dalin peshën e rëndë të dijes ta përcjellin lehtësisht me dashuri. Të tillë na nevojitet sot mësuesit, krijuesit, njerëzit e letrave në përgjithësi, me një vetëdije për të frymëzuar dhe tërhequr lexuesin tek libri dhe leximi. Se për të shijuar autorët e traditës, për t'i rivlerësuar dhe lexuar ndryshe na duhet së pari të edukojmë lexuesin e ri. Dhe kjo detyrë nuk bëhet veç me një fushatë, qoftë një muaj apo një vit. Bëhet çdo ditë, kudo, prej gjithë protagonistëve të dijes. Ndaj Mjedën sot e kujtojmë jo vetëm si poet të rrallë, por për më tepër dhe si misionar, si model të njeriut të përkushtuar dhe të vetëdijshëm për të zgjuar te ndjekësit e tij dashurinë për dijen, dashurinë për të bukurën, dashurinë për jetën.

Do të mjaftonin këto dy strofa për ta ndjerë si muzikë këtë dashuri për jetën:

*Nper ograjë po kënojnë bylbylat
Si tu'u prrallë me shoqi shojnë ;
Drandofilleve zymylat
T' kandshmen erë dhuntë ju çojnë,
E nalt n' qiell mâ e bukur hâna
Rreze t' paqta shkon tui shkrî ;
Maje bjeshkve fillon Zâna
N' valle shoqeve m' u prî.*



KONGRESI I MANASTIRIT- NJËRA NGA LËVIZJET MË EMANCIPUESE TË KULTURËS SHQIPTARE

Me 22 nëntor 1908, përfundoi punimet Kongresi i Manastirit, i cili, e miratoi alfabetin latin të gjuhës shqipe, të propozuar nga Shoqëria “Bashkimi”.

Ky Kongres, shënon njërën nga lëvizjet më emancipuese të kulturës shqiptare. Sepse, vendimet e tij, ishin tejet të dobishme, dhe i dhanë shtytje të fuqishme zhvillimit të shkrimit dhe arsimit shqip, por edhe lëvizjeve kombëtare.

Po ashtu, kjo veprimtari titanike, ndikoi në procesin e Pavarësinë Kombëtare, të shpallur katër vite pas, më 1912.

Kongresi i Manastirit (1908), me kryetar të komisionit poetin kombëtar, Gjergj Fishtën, mbetet njëra nga ngjarjet më madhore të kulturës shqiptare. Në këtë Kongres, morën pjesë delegatë nga të gjitha trojet shqiptare, dhe në përbërje kishte figura të rëndësishme atdhetare të kohës, siç ishin: Ndre Mjeda, Mithat Frashëri, Luigj Gurakuqi, dhe shume të tjerë.

Ky Kongres i dha vulë identitetit europian të shqiptareve, dhe njëkohësisht, i shpartalloi tendencat joeuropiane, të cilat çonin krye herë pas

here ndër ne.

Ky kongres, si i tillë, në planin kulturor, kombin shqiptar e lidhi përjetësisht me Europën. Nëse tipar thelbësor i një aksh identiteti është gjuha, atëherë shkrimi, alfabeti, është esenca e këtij identiteti.

Shkrimi është dëshmi e emancipimit dhe qytetërimit

Shkrimi shqip, i mbijetoi një katrahure të vërtetë, sidomos gjatë shekujve të errët të sundimit osman, kur u ndalua. Kjo u bë e mundur, në saje të dashurisë që treguan për të: Buzuku, Budi, Bogdani, Bardhi, dhe shumë e shumë titanë të tjerë. Sot, përjetësisht, duhet të jemi krenar me heronjtë e kulturës, guximtarë e përparimtarë, të cilët na lanë këtë pasuri kaq të vlefshme, shënjes të identitetit tonë.

Brezat tanë dhe ata që do të vijnë, e kanë për detyrë ta ruajnë dhe ta trashëgojnë këtë pasuri. Fjalët e Fishtës në këtë Kongres, janë kumbues dhe të vlefshme për secilën kohë- janë këshilla që na bëjnë më të ndërgjegjshëm dhe më të përgjegjshëm- edhe përpara sfidave që kemi sot, si komb, gjuhë dhe kulturë.

“Cila zemër prej shqiptari do të qëndrojë e pabindur përpara kësaj dite të shenjtë, që nuk e kemi shujtuar prej 500 vjet! Jo kurrë! Do të jetë turp i madh që të kthehemi si ardhme përveç që do të qeshemi nga bota e huaj, por do të shtimë popullin në dëshpërim.”

Vendimet e këtij Kongresi, duhet të shërbejnë si udhërrëfim për shqiptarët e përherëshëm. Dhe sidomos për të sotmit: për ata që janë ligështuar, për ata që i ka kapluar amnezia historike, dhe për ata që i ka rrëmbyer dalldia kozmopolite.



COMMISSIONE DELL'ALFABETO MONASTIR 1908

Foto Kel Marubi

- | | |
|--------------------------|-------------------|
| 1. Presidente P. Giorgio | 6. G. Cilka |
| Fishta O. M. | 7. Taqi Buda |
| 2. Mid - Frasheri | 8. Shahin Kolonja |
| 3. Luigj Gurakuqi | 9. Sotir Peci |
| 4. D. Qiriasi | 10. Bajo Topulli |
| 5. D. Ndre Mjeda | 11. Nyzhet Vriani |

PJESË E PASHLYESHME NGA VEPRIMTARIA E NDRE MJEDËS, PA ASNJË DYSHIM ËSHTË POEZIA

*“Ditët e Mjedës”, Kukël, 18. Nëntor 2017
Fjale përshëndetëse e Dom Nikë Ukgjinit*

I nderuar kryetar, Zef Hila, zv. kryeministre Senida Mesi, Ministre e kulturës, Mirela Kumbaro, të nderuar, studiues, poet, shkrimtar, të nderuar miq dashamirës të kulturës e në veçanti të poetit Dom Ndre Mjeda.

Jemi bashkuar në Qendrën Muzeale, në përkujtimin e ditës së lindjes të poetit të heshtur, idhnak, fjalëpak, por shumë të vyer dhe energjik dom Ndre Mjeda. Ai cilësohet edhe si person i pashoqërueshëm lehtë, imponues dhe i gatshëm për të kundërshtuar gjëra të cilat nuk ishin të arsyeshme. Por ishte i dashur me njerëzit dhe i gatshëm për tu flijuar tërësisht për grigjën në shërbim të cilës qëndroi për 42 vite me rradhë.

Hapësira në të cilën gjendemi, është pak sa e veçantë dhe emocionuese, sepse këtu për 30 vite me radhë (1906-1937), po në të njëjtin ambient dhe po në të njëjtin tryezë e cila gjenden në muzeun e kësaj Qendre, Mjeda, shkroi, rishkroi, botoi dhe ribotoi, pothuajse gjitha veprat e tij kulmore, e mbi gjitha veprën e Juvenilias, botuar në Vjenë 1917, se cilës sot po e kremtojmë 100 vjetorin e lindjes.

Botimi anastatik, i Juvenilias, saktësisht ashtu siç e pati botuar Poeti më 1917-ën, një shekull më parë në Vjenë, kur Mjeda ishte në kulmin e moshën e pjekurisë, është një shkas i mjaftueshëm për tu përmendur se vepra është një ekstrat më përfaqësuese e lirikës së tij, njërit prej lirikëve të papërsëritshëm të letërsisë shqipe, vlerësuar nga disa autor të kohës.

Pjesë e pashlyeshme nga veprimtaria e tij, pa asnjë

dyshim është poezia, ku poeti paraqet emocionet e veta, rreth brengave të ndryshme njerëzve të thjesht që e rrethonin, ngjarjeve të rëndësishme kombëtare, por dhe të atyre që lidheshin me shqiptaret. Por për mjedologun Mentor Quku, (botuar 13 vepra), poeti dom Ndre Mjeda, mbetet një figurë e madhe shqiptare edhe për shkak se ishte gjuhëtar i spikatur, në fillim më shoqërinë Bashkim, e më pas Agimi. Përkthyes i talentuar i veprave biblike dhe poezive nga letërsia botërore, nga viti 1883-1887 në Porto-Re (Dalmaci) dhe Chieri të Torinos. Pedagog i shquar në Cremona (1887-1891) dhe Porto Re (1895-1898) të Italisë dhe pas në Seminarin e Jezuitëve në Shkodër. Atdhetar i flakët i cili pas 20 viteve të studimeve nëpër disa qendra të Evropës në vitin 1899, kthehet e në Shqipëri ku së bashku me abat Preng Dochin, Ndoc Nikaj dhe disa të tjerë kontribuan pamasë në formimin e shtetit shqiptar.

Studiuesi francez K. Denio, do të shkruante, “Greqinë moderne e bënë detaret dhe tregtarët, Shqipërinë e bënë poetet”. Duke u mbështetur në dëshmitë e gazetarit vienez Paul Zibertz, për Mjedën, themi së ai ishte njëri ndër të tillët.

Ai me talentin e tij të lindur, la gjurmë të pashlyeshme në mendjen e zemrën e çdo shqiptari.

Prandaj, përkujtimi i tij i çdo vjetshëm dhe i veprave, siç jemi duke bërë, do na sjellë frymëzime të reja e të dobishme për ngritjen tonë shpirtërore, intelektuale dhe atdhetare.



VITRINË LIBRI



Angelo De Padova o.f.m

I LUMI DON
MIKEL BELTOJA

Galatina (LE) - Itali, 2017



Don Pashk Dani
Labinot Berisha

FISHTA

Faik Konica,
Prishtinë 2017



Dom Ndre Mjeda

JUVENILIA

Botimet Fishta,
Lezhë 2017

KUMBONA E SË DIELËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 1000 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë

KUMBONA E SË DIELËS

Viti XXX, nr. 11/12 (501-502) Nëntor - Dhjetor 2017